



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.102**

**6 gusht**

**2007**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9781 datë 19.7.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit HANNS - SEIDEL të Republikës Federale të Gjermanisë” .....	2941
Ligj nr.9783 datë 19.7.2007	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale malore” .....	2943
Ligj nr.9785 datë 19.7.2007	Për ratifikimin e “Kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom” .....	2952

**LIGJ**  
**Nr.9781, datë 19.7.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDACIONIT HANNS -  
SEIDEL TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit HANNS-SEIDEL të Republikës Federale të Gjermanisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5437, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE**  
**FONDACIONIT HANNS-SEIDEL TË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Fondacioni Hanns-Seidel, Mynih, Republika Federale e Gjermanisë, këtej e tutje referuar si Pala shqiptare dhe Fondacioni;

*duke njohur* rëndësinë e veprimtarisë së organizatave dhe institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare me karakter publik dhe privat në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe me synimin për nxitjen e kulturës dhe pjesëmarrjes demokratike dhe solidaritetit ndërkombëtar;

*duke vlerësuar* kontributin e Fondacionit për ndërtimin dhe zgjerimin e demokracisë, ngritjen dhe zgjerimin e një shoqërie civile funksionale dhe ngritjen dhe zgjerimin e strukturave dhe institucioneve në sektorin shtetëror, shoqëror dhe kulturor;

*me qëllim* sigurimin e mbështetjes ndaj Republikës së Shqipërisë në rrugën e saj drejt strukturave Euroatlantike,

ranë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët do të bashkëpunojnë në fusha me interes të përbashkët në kuadër të kërkesave të Shtetit Shqiptar dhe të veprimtarisë së Fondacionit dhe në veçanti:

a) në sektorin “politik”, Fondacioni do të kontribuojë në intensifikimin e bashkëpunimit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, veçanërisht me Shtetin e Lirë të Bavarisë;

b) në sektorin “ekonomi”, Fondacioni do të ofrojë mundësi trajnimi në fushën e menaxhimit

dhe marketingut për punonjësit e ndërmarrjeve private dhe shtetërore;

c) në sektorin e “administratës publike”, Fondacioni do të hartojë dhe zbatojë projekte për kualifikimin e nëpunësve të niveleve të ndryshme të Republikës së Shqipërisë në sektorët e administratës qendrore dhe vendore.

#### Neni 2

Përfaqësuesit e Palëve do të zhvillojnë takime periodike për të vlerësuar gjendjen e bashkëpunimit dhe për të vendosur për planet e ardhshme dhe fusha të tjera bashkëpunimi.

#### Neni 3

Autoritetet kompetente shqiptare angazhohen të marrin masat e nevojshme me qëllim lehtësimin e hyrjes, daljes dhe qëndrimit të anëtarëve të Fondacionit në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të përshpejtojnë dhe lehtësojnë procedurat e pajisjes me leje qëndrimi të tyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 4

Fondacioni do të jetë i përjashtuar nga detyrimet e importit dhe TVSH-së në import për realizimin e aktiviteteve të tij si: mobilje, pajisje elektronike për zyra, libra, automjete, si dhe sende personale.

#### Neni 5

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi për një periudhë pesëvjeçare që nga data e hyrjes së saj në fuqi dhe do të zgjatet automatikisht për periudha të tjera pesëvjeçare nëse asnjë nga Palët Kontraktuese nuk jep njoftim me shkrim për përfundimin e vlefshmërisë së saj 6 muaj më përpara.

#### Neni 6

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e njoftimit të Palës shqiptare se të gjitha kërkesat ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi janë përmbushur.

#### Neni 7

Marrëveshja për bashkëpunim në fushën ekonomike dhe administrative ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Fondacionit HANNS-SEIDEL të Republikës Federale të Gjermanisë, nënshkruar në Tiranë më 15.11.1992, shfuqizohet.

Nënshkruar më 2.4.2007 në Tiranë në dy kopje origjinale, secila në gjuhët shqip dhe gjermanisht.

**LIGJ**  
**Nr.9783, datë 19.7.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEC-UT PËR  
ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË ZONAVE RURALE MALORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të OPEC-ut për zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale malore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5438, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

**PROJEKTI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM TË ZONAVE RURALE MALORE**

**MARRËVESHJA E HUASË**  
**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FONDIT TË OPEK-UT PËR ZHVILLIM**  
**NDËRKOMBËTAR**

Marrëveshje e datës \_\_\_\_\_, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (këtu i quajtur Huamarrësi) dhe Fondit të OPEK-ut për Zhvillim Ndërkombëtar (këtu i quajtur OFID).

Meqenëse shtetet anëtare të OPEK-ut, duke qenë në dijeni të nevojës për solidaritet midis të gjitha vendeve në zhvillim dhe duke ditur rëndësinë e bashkëpunimit financiar ndërmjet tyre dhe vendeve të tjera në zhvillim, kanë krijuar fondin për t'u siguruar mbështetje financiare këtyre

vendeve të fundit në kushte koncesioni, përveç kanaleve bilaterale dhe multilaterale nëpërmjet të cilave shtetet anëtare të OPEK-ut zgjerojnë asistencën financiare drejt vendeve të tjera në zhvillim;

*dhe duke qenë* se Huamarrësi ka kërkuar asistencë nga OFID-i për financimin e projektit të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje;

*dhe duke qenë* se ndërmjet të tjerash, Huamarrësi i ka kërkuar, gjithashtu Fondit Ndërkombëtar për Zhvillimin e Bujqësisë (IFAD-it) të asistojë në financimin e projektit duke dhënë për këtë një hua;

*dhe duke qenë* se Bordi Drejtues i OFID-it ka miratuar shtimin e huasë së Huamarrësit në jo më shumë se katër milionë e pesëqind e njëzet mijë dollarë amerikanë (4 520 000 USD), sipas afateve dhe kushteve që parashtrohen këtu, dhe ka miratuar më tej që Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projekti (UNOPS) t'i besohet detyra e administrimit të huasë së dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje;

tashmë, Palët janë marrë vesh si më poshtë:

## Neni 1 Përkufizime

1.01 Kudo që përdoren në këtë Marrëveshje, në qoftë se konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "OFID" do të thotë Fondi i OPEK-ut për Zhvillim Ndërkombëtar, i krijuar nga shtetet anëtare të Organizatës së Vendeve Eksportuese të Naftës (OPEK), mbështetur në Marrëveshjen e nënshkruar në Paris më 28 janar të vitit 1976, e ndryshuar;

b) "Menaxhuesi i OFID-it" do të thotë Drejtori i Përgjithshëm i OFID-it ose përfaqësuesi i autorizuar i tij;

c) "Administrues huaje" do të thotë UNOPS-i ose agjenci të tjera për të cilat mund të bien dakord Huamarrësi dhe Menaxhuesi i Fondit;

d) "Hua" do të thotë huaja e dhënë në pajtim me këtë Marrëveshje;

e) "Dollar" ose shenja "S" do të thotë monedha e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;

f) "Projekt" do të thotë projekti për të cilin është dhënë huaja, siç paraqitet në shtojcën 1 të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas përshkrimit mund të ndryshohet herë pas here sipas marrëveshjes ndërmjet Huamarrësit dhe Menaxhuesit të OFID-t;

g) "Mallra" do të thotë pajisje, furnizime dhe shërbime që nevojiten për projektin. Referuar kostos së mallrave, mendohet që ajo të përfshijë gjithashtu koston e importit të këtyre mallrave në territoret e Huamarrësit;

h) "Agjenci zbatuese" do të thotë Agjencia e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) dhe Fondi i Financimit të Zonave Malore (MAFF) ose agjenci të tjera për të cilat Huamarrësi dhe Menaxhuesi i OFID-it bien dakord;

i) "Data e mbylljes" do të thotë data e specifikuar në ose në pajtim me paragrafin 2.10 të kësaj Marrëveshjeje;

j) "Data e hyrjes në fuqi" do të thotë data në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

## Neni 2 Huaja

2.01 Një hua prej katër milionë e pesëqind e trembëdhjetë mijë dollarë (4 513 000 \$) i është dhënë Huamarrësit nga OFID-i, sipas afateve dhe kushteve të paraqitura në këtë Marrëveshje.

2.02 Huamarrësi paguan interes në masën prej tre e një të katërtën përqind (3.25%) në vit të shumës kryesore të huasë së pashlyer në mënyrë periodike.

2.03 Huamarrësi duhet të paguajë herë pas here një tarifë shërbimi në koeficientin një përqind (1%) në vit të shumës kryesore të huasë së tërhequr dhe të pashlyer, për të mbuluar shpenzimet e administrimit të huasë.

2.04 Interesat dhe tarifat e shërbimit paguhen në dollarë dy herë në vit, çdo 15 mars dhe 15 shtator të çdo viti në një llogari të OFID-it, të përcaktuar për këtë qëllim nga Menaxhuesi i OFID-it.

2.05 Pasi Marrëveshja të daklorohet në fuqi në pajtim me paragrafin 7.01 dhe nëse Huamarrësi dhe OFID-i nuk bien dakord ndryshe, të ardhurat e huasë mund të tërhiqen herë pas here për të mbuluar shpenzimet e kryera pas 13 qershorit 2006 ose bëhen në datat e mëvonshme, lidhur me koston e arsyeshme të mallrave që nevojiten për projektin, të cilat financohen nga të ardhurat e huasë siç është paraqitur në shtojcën 2 të kësaj Marrëveshjeje dhe në amendamentet e kësaj shtojce, të miratuar sipas rregullit nga Menaxhuesi i OFID-it.

2.06 Përveç, rastit kur Menaxhuesi i OFID-it bie dakord ndryshe, tërheqjet nga huaja mund të bëhen në monedhën në të cilën janë paguar ose paguhen shpenzimet e paragrafit 2.05. Në rastin kur pagesa kërkohet në një monedhë të ndryshme nga dollari, kjo pagesë kryhet në bazë të kostos aktuale të dollariF të kërkueshme për fondin për të plotësuar kërkesën. Menaxhuesi i OFID-it vepron si agjent i Huamarrësit në blerjen e monedhave. Tërheqjet lidhur me shpenzimet në monedhën e Huamarrësit, nëse ka, bëhen në dollarë sipas kursit të këmbimit në momentin e tërheqjes, dhe në mungesë të këtij kursi sipas një kursi të arsyeshëm që Menaxhuesi i OFID-it vendos herë pas here.

2.07 Kërkesat për tërheqje përgatiten në dy kopje origjinale të barasvlefshme në përputhje me procedurat e disbursimit për fondet e OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar të miratuara në maj të vitit 1983, një kopje e të cilës i është dhënë Huamarrësit. Një kopje origjinale e secilës prej kërkesave për tërheqje i paraqitet, përkatësisht OFID-it dhe Administratorit të Fondit nga përfaqësuesi i Huamarrësit, i përcaktuar në ose në përputhje me paragrafin 8.02. Çdo kërkesë e paraqitur në këtë mënyrë shoqërohet me dokumente dhe prova të tjera të mjaftueshme në formë dhe përmbajtje për të bindur OFID-in dhe Administratorin e Fondit që Huamarrësi ka të drejtën të tërheqë nga huaja shumën e kërkuar dhe shuma që do të tërhiqet do të përdoret vetëm për qëllimet e specifikuar në Marrëveshje.

2.08 Huamarrësi shlyen shumën principale të huasë në dollarë ose në ndonjë monedhë tjetër të konvertueshme të pranueshme nga Menaxhuesi i OFID-it në shumën ekuivalente me shumën në dollarë, sipas kursit të këmbimit valutor në treg që ekziston në momentin dhe vendin e shlyerjes. Shlyerja kryhet në tridhjetë këste gjashtëmujore duke filluar nga 15 shtatori 2011, pas një afati kohor shtyrje pagese pa detyrim interesi ose gjobe deri në atë datë dhe në përputhje me planin kohor të amortizimit të kësaj Marrëveshjeje. Çdo këst do të jetë në vlerën njëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë dollarë (150 430\$), përveç këstit të fundit të tridhjetë, i cili do të jetë në vlerën njëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e tridhjetë dollarë (150 530 \$) dhe të gjitha këstet transferohen në datën e shlyerjes në llogarinë e OFID-it, sipas kërkesës së Menaxhuesit të OFID-it.

2.09 (a) Huamarrësi ndërmerr të sigurojë se ansjë borxh i jashtëm nuk ka prioritet mbi këtë hua në alokimin, realizimin ose shpërndarjen e monedhës së huaj që mbahet nën kontroll ose në përfitim të Huamarrësit. Nëse një barrë vendoset mbi një send pasuror publik (siç paraqitet në paragrafin 2.09 (c), si garanci për çdo borxh të jashtëm, i cili rezulton ose mund të rezultojë prioritar në interes të kreditorit të borxhit të jashtëm në alokimin, realizimin ose shpërndarjen e këmbimit të huaj, barra, *ipso facto*, siguron në mënyrë të barabartë dhe pa kosto për OFID-in shumën principale dhe tarifën mbi huanë dhe Huamarrësi, në krijimin ose lejimin e krijimit të kësaj barre, e parashikon këtë shprehimisht, me kusht që nëse për një arsye kushtetuese ose ligjore ky parashikim nuk mund të bëhet lidhur me një barrë të krijuar mbi sendet pasurore të një nënndarjeje politike ose administrative, Huamarrësi siguron menjëherë dhe pa kosto për OFID-in shumën principale të, dhe tarifën mbi huanë me një barrë ekuivalente mbi sende të tjera pasurore publike të pranueshme nga Fondi.

b) Detyrimet e mësipërme nuk aplikohen për:

i) një barrë mbi pronën, në momentin e blerjes, vetëm si garanci për pagesën e çmimit të blerjes së asaj prone; dhe

ii) çdo barrë që lind në rrjedhën e zakonshme të transaksioneve bankare dhe që siguron maturimin e borxhit për një afat kohor, jo më tepër se një vit pas kësaj date.

c) Siç përdoret në këtë paragraf, termi “sende pasurore publike” do të thotë sende pasurore të Huamarrësit ose të çdo nënndarjeje politike apo administrative, ose e një subjekti që zotërohet ose kontrollohet nga, ose që operon për llogari ose përfitim të Huamarrësit, ose një nënndarjeje të tillë, përfshirë sendet pasurore në ar ose të këmbimit të huaj që zotërohen nga një institucion që kryen

funksionet e një banke qendrore ose fondi këmbimi stabilizimi ose funksione të ngjashme për Huamarrësin.

2.10 E drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga të adhurat e huasë, shfuqizohet në 31 gusht 2011 ose në një datë të mëvonshme që caktohet nga Menaxhuesi i OFID-it. Menaxhuesi i OFID-it informon menjëherë Huamarrësin mbi këtë datë të mëvonshme.

### Neni 3

#### Zbatimi i projektit

3.01 Huamarrësi duhet të zbatojë projektin me përkushtimin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me të gjitha praktikatat e shëndosha administrative, financiare dhe inxhinierike dhe siguron në monentim e duhur fondet, pajisjet, shërbimet dhe burime të tjera, përveç të ardhurave të huasë që kërkohen për këtë qëllim.

3.02 Huamarrësi siguron që aktivitetet e departamenteve dhe agjencive të tij në lidhje me ndërmarrjen e projektit të drejtohen dhe koordinohen në përputhje me politikat dhe procedurat e përshtatshme administrative.

3.03 (a) Huamarrësi ndërmerr të sigurojë ose të parashikojë si duhet sigurimin e mallrave të importuara që financohen nga huaja kundrejt rreziqeve gjatë përfitimit, transportimit dhe dorëzimit në vendin e përdorimit ose instalimit, dhe për një sigurim të tillë çdo zhdëmtim paguhet në një monedhë lirisht të përdorshme nga Huamarrësi për të zëvendësuar ose riparuar këto mallra.

b) Përveç, në rastin kur OFID-i bie dakord ndryshe, të gjitha mallrat dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e huasë përdoren ekskluzivisht për projektin.

c) Prokurimi i mallrave sipas kësaj Marrëveshjeje janë përgjithësisht në përputhje me dispozitat e udhëzimeve të prokurimit sipas huasë së dhënë Fondi i OPEC-it, e miratuar më 2 nëntor të vitit 1982, një kopje e së cilës i është dhënë Huamarrësit ose në përputhje me procedura të tjera, jo të papajtueshme me këto, siç mund të pranohet nga Menaxhuesi i OFID-it.

3.04 (a) Huamarrësi duhet t'i paraqesë OFID-it dhe Administratorit të huasë, menjëherë pas përgatitjes së tyre, planet, kushtet, dokumentet e kontratës dhe afatet e ndërtimit dhe prokurimit të projektit dhe çdo modifikim të materialit ose shtesa, siç mund t'i kërkojë OFID-i ose Administratori i huasë.

b) Huamarrësi:

i) mban të dhëna dhe procedura të përshtatshme për të regjistruar dhe monitoruar progresin e projektit (përfshirë koston e tij dhe përfitimet që nxirren prej tij), për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e huasë, dhe për të treguar përdorimin e tyre në projekt;

ii) u jep mundësi përfaqësuesve të OFID-it Administratorit të huasë të vizitojë vendndodhjen e mjeteve dhe ndërtimeve që përfshihen në projekt, si dhe të ekzaminojë mallrat dhe punimet e financuara nga të ardhurat e huasë, si dhe çdo të dhënë dhe dokument përkatës; dhe

iii) në intervale të vazhdueshme, i siguron OFID-it dhe Administratorit të huasë të gjitha informacionet që mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme OFID-i ose Administratori i huasë lidhur me projektin, koston e tij dhe sipas rastit, përfitimet që rrjedhin nga ato, shpenzimet nga të ardhurat e huasë, si dhe mallrat, punimet dhe shërbimet që financohen nga këto të ardhura, si dhe një raport tremujor mbi progresin gjatë zbatimit të projektit.

c) Menjëherë pas përfundimit të projektit, por në çdo moment jo më vonë se 6 muaj pas datës së mbylljes, ose në një datë të mëvonshme, siç mund të bihet dakord pas këshillimit midis Huamarrësit, Administratorit të huasë dhe OFID-it, Huamarrësi përgatit dhe i siguron Administratorit të Fondit dhe huasë një raport me objekt dhe detaje sipas kërkesës së Menaxhuesit të OFID-it, mbi zbatimin dhe operimin fillestar të projektit, koston e tij dhe përfitimet që merren dhe duhet të merren nga ai, përmbushjen nga Huamarrësi dhe OFID-i i detyrimeve të tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje, si dhe arritjen e objektivave të huasë.

3.05 Huamarrësi mban ose realizon mbajtjen e regjistrave për të pasqyruar, në përputhje me praktikatat e llogarive të unifikuara, operacionet, burimet dhe shpenzimet, lidhur me projektin, të

departamenteve ose agjencive të Huamarrësit përgjegjës për zbatimin e projektit ose një pjesë të tij, dhe ia vë në dispozicion këto të dhëna OFID-it dhe Administratorit të huasë me kërkesë të një pale.

3.06 Në masën që është në përputhje me këtë Marrëveshje, Huamarrësi përmbush kundrejt OFID-it të gjitha kushtet e Fondit lidhur me ekzekutimin dhe administrimin e projektit që Huamarrësi bie dakord në Marrëveshjen e huasë të nënshkruar ose që do të nënshkruhet me IFAD-in për financimin e pjesshëm të projektit dhe referencat tek IFAD-i në një Marrëveshje të tillë konsiderohen për qëllimet e kësaj dispozite të jenë referenca tek OFID-i.

3.07 Sipas parashikimit të paragrafit 3.06, Huamarrësi konsultohet me OFID-in përpara se të bjerë dakord me IFAD-in mbi amendamentet e kushteve që lidhen me ekzekutimin ose administrimin e projektit. Asnjë amendament nuk mendohet të përfshihet në këtë Marrëveshje pa miratimin paraprak të OFID-it.

3.08 Duke njohur plotësisht rolin e Administruesit të huasë në mbikëqyrjen e zbatimit të projektit, përfshirë rishikimin dhe miratimin e kontratave të projektit dhe miratimin e prokurimeve dhe kërkesave për tërheqje, Huamarrësi bashkëpunon ngushtë me Administratorin e huasë për t'u siguruar se qëllimi i huasë do të përmbushet. Në kontekstin e mësipërm, Huamarrësi herë pas here duhet:

a) shkëmben opinione me OFID-in dhe Administratorin e huasë lidhur me progresin e projektit, përfitimet e siguruar nga ai dhe përmbushjen e detyrimeve të Huamarrësit sipas kësaj marrëveshjeje, si dhe çështje të tjera që lidhen me qëllimin e Huasë;

b) informon menjëherë OFID-in dhe administratorin e Huasë mbi çdo kusht që ndërhyt ose rrezikon të ndërhyt në progresin e Projektit ose përmbushjen nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

3.09 Të gjitha referencat të Huamarrësi në këtë nen interpretohen *mutatis mutandis*, sikur përfshijnë referenca në agjencinë ekzekutive.

#### Neni 4

##### **Përjashtimet**

4.01 Kjo Marrëveshje dhe ndonjë marrëveshje suplementare midis Palëve janë të lira nga taksat, detyrimet ose tarifat e vendosura nga, ose në territorin e Huamarrësit mbi ose në lidhje me zbatimin, dhënien ose regjistrimin.

4.02 Shuma principale, interesat dhe tarifat e shërbimit mbi huanë paguhen pa zbritje dhe të lira nga çdo tarifë dhe kufizim të ndonjë lloji të vendosur nga ose në territorin e Huamarrësit.

4.03 Gjithë dokumentet, regjistrat, korrespondenca dhe materiale të ngjashme konsiderohen konfidenciale nga Huamarrësi, nëse nuk bihet dakord ndryshe nga OFID-i.

4.04 OFID-i dhe sendet e tij pasurore nuk i nënshtrohen asnjë mase shpronësimi, shtetëzimi ose sekuestrimi në territorin e Huamarrësit.

#### Neni 5

##### **Përshpejtimi i maturimit, pezullimi dhe anulimi**

5.01 Nëse ndodh një nga situatat e mëposhtme dhe që vazhdon për periudhën e specifikuar më poshtë, atëherë në çdo kohë gjatë vazhdimin të asaj situatë, Menaxhuesi i OFID-it, duke njoftuar Huamarrësin, mund të deklarojë shumën principale të papaguar dhe të kërkueshme të huasë, e cila është e pagueshme menjëherë së bashku me interesin dhe tarifën e shërbimit dhe në këtë rast shumën principale, bashkë me interesin dhe të gjitha tarifat, bëhet menjëherë e kërkueshme dhe e pagueshme:

a) Vonesa ndodh dhe vazhdon për një periudhë 30-ditore në pagesën e çdo kësti të principalit ose interesit, ose të tarifave të shërbimit sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas çdo marrëveshjeje tjetër



për shkak të së cilës Huamarrësi ka marrë ose do të marrë hua nga OFID-i;

b) Vonesa ndodh gjatë përmbushjes së çdo detyrimi tjetër nga ana e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjes së projektit, nëse ekzistojnë dhe kjo vonesë vazhdon për një periudhë 60-ditore pas njoftimit të Huamarrësit nga OFID-i.

5.02 Huamarrësi duke njoftuar OFID-in, mund të pezullojë çdo shumë të huasë, të cilën Huamarrësi nuk e ka tërhequr para një njoftimi të tillë. OFID-i duke njoftuar Huamarrësin, mund të pezullojë ose pushojë të drejtën e Huamarrësit për të bërë tërheqje nga huaja nëse ndodh një nga situatat e përmendura në paragrafin 5.01 (a) dhe (b), ose nëse e drejta e Huamarrësit për të bërë tërheqje sipas Huasë së IFAD-it referuar në Preambulë të kësaj Marrëveshjeje është pezulluar ose anuluar, ose në rastin e çdo shtate tjetër të pazakontë, e cila bën të pamundur përmbushjen e suksesshme të projektit, ose për Huamarrësin të jetë në gjendje të kryejë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Pavarësisht përshpejtimit të maturimit të huasë në pajtim me seksionin 5.01 ose pezullimit, si dhe anulimit të tij në pajtim me seksionin 5.02, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje vazhdojnë të mbeten plotësisht në fuqi, përveç sa parashikohet në mënyrë specifike në këtë nen.

5.04 Nëse nuk bihet dakord ndryshe midis Huamarrësit dhe Menaxhuesit të OFID-it, çdo anulim aplikohet *pro rata* në maturimet e ndryshme të shumës principale të Huasë, e cila maturohet pas datës së një pezullimi të tillë.

## Neni 6

### **Detyrimi, përfundimi i Fondit, arbitrazhi**

6.01 Të drejtat dhe detyrimet e Palëve në këtë Marrëveshje janë të vlefshme dhe të ekzekutueshme në përputhje me kushtet e tyre, pavarësisht ligjeve të pafavorshme lokale. Asnjë Palë në këtë Marrëveshje nuk ka të drejtë në çdo rrethanë të ngrejë ndonjë pretendim që një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme ose e paekzekutueshme për arsye të ndryshme.

6.02 Menaxhuesi i OFID-it duhet të informojë menjëherë Huamarrësin në çdo rast vendimmarrje për shpërbërjen e OFID-it në përputhje me marrëveshjen themeluese të Fondit. Në rastin e një shpërbërjeje të tillë, kjo Marrëveshje Huaje mbetet në fuqi dhe Menaxhuesi i OFID-it këshillon Huamarrësin për çdo masë zëvendësuese për shlyerjen e huasë si mund të konceptohet nga autoriteti i duhur i OFID-it në raste të tilla.

6.03 Palët në këtë Marrëveshje përpiqen të zgjidhin në mënyrë miqësore të gjitha konfliktet ose mospajtimet midis tyre, të cilat lindin nga Marrëveshja ose që lidhen me të. Nëse konflikti ose mospajtimi nuk zgjidhet në mënyrë miqësore i nënshtrohen gjykimit në arbitrazh nga Gjykata e Arbitrazhit si paraqitet në poshtë:

a) Gjykimi në arbitrazh mund të niset nga Huamarrësi kundër OFID-it ose e kundërta. Në të gjitha rastet, gjykimet në arbitrazh nisen nëpërmjet një njoftimi që pala paditëse i bën palës së paditur.

b) Gjykata e Arbitrazhit përbëhet nga tre gjyqtarë arbitrazhi të emëruar si vijon: një nga pala paditëse, i dyti nga pala e paditur dhe i treti (i quajtur kryegjyqtar arbitrazhi) me marrëveshje të dy gjyqtarëve arbitrazhi. Nëse brenda 30 ditëve pas njoftimit të fillimit të procedurave të arbitrazhit pala e paditur nuk arrin të emërojë një gjyqtar arbitrazhi, ky gjyqtar arbitrazhi emërohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë me kërkesë të palëve që nisin gjykimin. Nëse të dy gjyqtarët e arbitrazhit nuk arrijnë të bien dakord mbi emërimin e kryegjyqtarit të arbitrazhit, brenda 60 ditëve pas datës së emërimit të gjyqtarit të dytë të arbitrazhit, ky kryegjyqtar arbitrazhi emërohet nga Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

c) Gjykata e Arbitrazhit mblidhet në kohën dhe vendin e caktuar nga kryegjyqtari i arbitrazhit. Pas kësaj, ajo vendos se ku dhe kur do të mblidhet. Gjykata e Arbitrazhit përcakton të gjitha çështjet e procedurave dhe çështjet që lidhen me kompetencat e saj.

d) Të gjitha vendimet e Gjykatës së Arbitrazhit merren me shumicë votash. Vendimi i Gjykatës, i cili mund të jepet edhe nëse njëra nga palët nuk merr pjesë, është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për të dy palët në gjykimin e arbitrazhit.

e) Kryerja e çdo njoftimi ose veprimi lidhur me çdo gjykm sipas këtij seksioni ose lidhur me çdo gjykim për zbatimin e çdo vendimi të dhënë në pajtim me këtë seksion, bëhen sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin 8.01.

f) Gjykata e Arbitrazhit vendos mbi mënyrën se si shpenzimet e arbitrazhit mbuloen nga secila ose të dy palët në konflikt.

## Neni 7

### **Data e hyrjes në fuqi: prishja e kësaj Marrëveshjeje**

7.01 Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën në të cilën OFID-i i paraqet Huamarrësit njoftimin e pranimit të provave të kërkuara nga seksionet 7.02 dhe 7.03.

7.02 Huamarrësi i siguron OFID-it prova të pranueshme që:

a) zbatimi dhe dhënia e kësaj Marrëveshjeje në interes të Huamarrësit janë autorizuar dhe ratifikuar siç duhet sipas kërkesave kushtetuese të Huamarrësit; dhe

b) marrëveshja në lidhje me huanë e IFAD-it të paraqitur në preambulë të kësaj Marrëveshjeje është deklaruar në fuqi ose do të deklarohet në fuqi njëkohësisht me këtë marrëveshje.

7.03 Në pajtim me seksionin 7.02, Huamarrësi i siguron OFID-it një certifikatë të lëshuar nga Ministria e Drejtësisë ose Prokurori i Përgjithshëm, ose nga departamenti kompetent ligjor qeveritar, sipas së cilës kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ratifikuar nga Huamarrësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit në përputhje me kushtet e tij.

7.04 Nëse kjo Marrëveshje nuk hyn në fuqi në datën \_\_\_\_\_, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve e humbin fuqinë, përveç kur OFID-i, pas shqyrtimit të arsyeve të vonesave, cakton një datë të mëvonshme për arsye të këtij seksioni.

7.05 Kur e gjithë shuma principale e huasë të shlyhet, si dhe interesat dhe të gjitha tarifat që kanë të bëjnë me huanë të paguhen, kjo Marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve sipas saj e humbin menjëherë fuqinë.

## Neni 8

### **Njoftimi, përfaqësimi, modifikimi**

8.01 Çdo njoftim ose kërkesë që nevojitet ose pranohet të paraqitet, ose kryhet sipas kësaj Marrëveshjeje bëhet me shkrim. Ky njoftim ose kërkesë mendohet të jetë paraqitur ose kryer kur dorëzohet dorazi, me postë ose telefaks palës së cilës kërkohet t'i jepet, në adresën e palëve të specifikuar më poshtë ose në çdo adresë tjetër që kjo palë i ka specifikuar me shkrim palës që bën njoftimin ose kërkesën.

8.02 Çdo veprim që kërkohet ose pranohet të kryhet dhe çdo dokument i kërkuar, ose që pranohet të zbatohet sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit ndërmerret ose zbatohet nga Ministri i Financave të Huamarrësit ose një punonjës tjetër i autorizuar me shkrim nga ai.

8.03 Çdo modifikim i dispozitave të kësaj Marrëveshjeje mund të miratohet në emër të Huamarrësit nëpërmjet dokumentit me shkrim të zbatuar nga përfaqësuesi i Huamarrësit të përcaktuara në, ose në përputhje me seksionin 8.02, me kusht që sipas këtij përfaqësuesi modifikimi është i arsyeshëm në këto rrethana dhe nuk rrit dukshëm detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

8.04 Çdo dokument i paraqitur në përputhje me këtë Marrëveshje është në gjuhën angleze. Çdo dokument në gjuhë tjetër shoqërohet me përkthimin në anglisht me vërtetim që tregon se përkthimi është i miratuar dhe ky përkthim i miratuar është përfundimtar për palët.

Në dëshmi të sa më sipër, Palët që veprojnë nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar në mënyrën e duhur, kanë mundësuar nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje dhe dorëzimin në Vjenë në 2 kopje në gjuhën angleze, ku secila çmohet kopje origjinale dhe ka të njëjtin ndikim si në ditën dhe vitin e përshkruar më sipër.

Për Huamarrësin	Për Fondin e OPEK-ut për Zhvillim Ndërkombëtar
Emri	Emri:
Adresa: Ministria e	Adresa: Fondi i OPEK-ut për Zhvillim Ndërkombëtar
Financave	P.O. Box 995
Bulevardi “Dëshmorët e	A-1011 Vienna
Kombit”	Austria
Tiranë	Fax: (43) 1 5139238
Republika e Shqipërisë	
Fax: (355) 4 229 200	

## PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË ZONAVE MALORE RURALE

### SHTOJCA I PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti synon rritjen e të ardhurave të familjeve në segmentet e varfra të popullsisë, duke u përpjekur të arrijë mobilizimin shtesë të burimeve, rritjen e përshpejtuar të shoqëruar me reduktimin e varfërisë dhe rritjen e kapacitetit institucional për të influencuar dhe mbështetur investimet në sektorët publikë dhe privatë.

Objektivat e projektit do të arrihen nëpërmjet zbatimit të komponentëve të mëposhtëm:

a) Zhvillimit të programit rajonal

Ky komponent përfshin: (i) ndërtimin e rrjeteve për të krijuar Agjencinë e Zhvillimit të Zonave Malore (MADA) dhe për të nxitur investimet nga brenda; (ii) studime dhe kërkime për krijimin e MADA-s, si një bazë njohurish në rrafsh kombëtar në zonat malore; dhe (iii) forcimin e komuniteteve për të marrë pjesë në zhvillimin lokal.

b) Zhvillimi i sektorit privat

Ky komponent përfshin: i) zhvillimin e biznesit duke lidhur bizneset në zhvillim me sigurues të ndryshëm shërbimesh të zhvillimit të biznesit që operojnë në zonat rurale; ii) informimin e sipërmarrësve në lidhje me mundësitë e investimit optimal lokal; dhe iii) ngritjen e kapacitetit nëpërmjet mbështetjes së institucioneve trajnuese lokale.

c) Zbatimi në terren dhe testimi i metodave të investimit

Ky komponent do të përfshijë mbështetje për: i) infrastrukturën ekonomike në shkallë të ulët nëpërmjet granteve kontribuese; ii) rinovimin e teknologjisë nëpërmjet granteve me konkurrim; dhe iii) koordinimin dhe shpërndarjen e shërbimeve veterinarë publike.

d) Transformimi dhe zgjerimi i MAFF-it

Ky komponent synon konvertimin e fondit të financimit të zonave malore (MAFF) në një bankë tregtare rurale plotësisht të licencuar që siguron një gamë të gjerë shërbimesh financiare.

e) Organizimi dhe menaxhimi i MADA-s

Qëllmi i këtij komponenti është të sigurojnë mbështetjen e mjaftueshme për MADA-n në mënyrë që të mund të lëvizë vazhdimisht drejt mundësive të reja, duke ia lënë zbatimin e investimeve agjencive të tjera ose sektorit privat.

## PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË ZONAVE MALORE RURALE

### SHTOJCA 2 ALOKIMI I HUASË

1. Nëse nuk bihet dakord ndryshe midis Huamarrësit dhe Menxhuesit të OFID-it, tabela e

mëposhtme paraqet komponentët, të cilët do të financohen nga të ardhurat e huasë, alokimin e shumave të huasë për çdo komponent dhe përqindjen e shpenzimeve totale për zërat që do të financohen për çdo komponent:

Shuma e huasë së alokuar (e shprehur në Përqindja e shpenzimeve totale që do të financohen \$ amerikanë)

---	--
--	--
3 760 000	29.08
3 380 000	
380 000	
753 000	14.13
--	
4 513 000	

2. Pavarësisht alokimit të shumës së huasë ose disbursimit të përqindjeve të paraqitura në tabelën në paragrafin 1 më sipër, nëse Menaxhuesi i OFID-it ka vlerësuar në mënyrë të arsyeshme që shuma e huasë së alokuar për çdo komponent do të jetë e pamjaftueshme për të financuar përqindjen e shpenzimeve që është rënë dakord në atë komponent, Menaxhuesi i OFID-it, duke njoftuar Huamarrësin, mund të: (i) rialokojë për këtë komponent, në nivelin që kërkohet për të plotësuar mungesat e vlerësuara, të ardhurat e huasë të cilat më pas i alokohen komponentëve të tjerë dhe që sipas Menaxhuesit të OFID-it nuk nevojiten për të plotësuar shpenzimet e tjera; dhe (ii) nëse ky rialokim nuk plotëson plotësisht mungesat e vlerësuara, mund të reduktojë përqindjen e disbursimit që aplikohet më pas në këto shpenzime, në mënyrë që tërheqjet e mëtejshme lidhur me këtë komponent të vazhdojnë derisa të kryhen të gjitha shpenzimet.

#### PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË ZOAVE MALORE RURALE

##### SHTOJCA 3 SHTOJCA E AMORTIZIMIT

Data e shlyerjes	Shuma përkatëse (E shprehur në dollarë amerikanë)	
15 shtator 2011	150,430	
15 mars 2012		150,430
15 shtator 2012		150,430
15 mars 2013	150,430	
15 shtator 2013	150,430	
15 mars 2014		150,430
15 shtator 2014		150,430

15 mars 2015			150,430		
15 shtator 2015		150,430			
15 mars 2016			150,430		
	15 shtator 2016				150,430
15 mars 2017			150,430		
	15 shtator 2017				150,430
15 mars 2018					150,430
15 shtator 2018		150,430			
15 mars 2019			150,430		
	15 shtator 2019				
15 mars 2020			150,430		
	15 shtator 2020				150,430
15 mars 2021					150,430
15 shtator 2021		150,430			
15 mars 2022			150,430		
	15 shtator 2022				150,4
15 mars 2023			150,430		
	15 shtator 2023				150,430
15 mars 2024					150,430
15 shtator 2024		150,430			
15 mars 2025			150,430		
	15 shtator 2025				150,4
15 mars 2026			150,530		
	Totali:				4,513,000

**LIGJ**  
**Nr.9785, datë 19.7.2007**

**PËR RATIFIKIMIN E “KONTRATËS PËR BLERJEN E AKSIONEVE TË SHOQËRISË ANONIME “ALBTELECOM””**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Kontrata për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime “Albtelecom””, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5440, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi**

ALBTELECOM SHA  
KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH  
TIRANË, 19.6.2007

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË  
Nr.3454 Rep.  
Nr.1187 Kol.

KONTRATË PËR BLERJE AKSIONESH

Sot, më datë 19.6.2007, në Tiranë, përpara meje noterit Julian Zhelegu, Noter i Dhomës së Noterëve, Tiranë, u paraqitën përfaqësuesit e palëve të mëposhtme:

Shteti Shqiptar përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, e përfaqësuar nga Shkëlqesia e Tij, Ministri z. Genc Ruli (më poshtë referuar si “Shitësi” ose “Ministria”),

dhe

CETEL Çalik Enerji Telekomunikasyon Hizmetleri A.S, një shoqëri e krijuar sipas ligjeve të Republikës së Turqisë (më poshtë “CETEL”), me seli në Keresteciler Sitesi Fatih Caddesi Selvi Sokak No 18 Merter Istanbul, e përfaqësuar nga z. Ahmet Çalik dhe Z. Ertugrul Gurler, në cilësinë e përfaqësuesve ligjorë.

Unë, noteri, pasi verifikova dokumentacionin e paraqitur nga palët ose përfaqësuesit e tyre, vërtetova se përfaqësuesit janë madhorë dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar. Palët, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, kanë kërkuar dhe kanë rënë dakord për hartimin e kësaj Kontrate, sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:

**MEQENËSE EKZISTOJNË KËTO KUSHTE PARAPRAKE**

a) Albtelecom sh.a. (më poshtë referuar si “Albtelecom” ose “Shoqëria”) është një shoqëri anonime me 100% (njëqind për qind) kapital shtetëror, e themeluar më 16 shkurt 1999 dhe që ushtron veprimtarinë e saj sipas të drejtës shqiptare, me seli në Tiranë, rruga “Myslym Shyri” nr.42, me kapital aksionar prej 17 526 625 000 (shtatëmbëdhjetë miliardë e pesëqind e njëzet e gjashtë e gjashtëqind e njëzet e pesë milionë), lekë të paguara plotësisht në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate;

b) Shitësi është pronari i ligjshëm i 17 526 625 (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind e njëzet e gjashtë mijë gjashtëqind e njëzet e pesë) aksioneve të zakonshme të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 1 000 (njëmijë) lekë secili, që përfaqësojnë 100% (njëqind për qind) të të gjithë kapitalit aksionar të Shoqërisë;

c) Shitësi me marrëveshje të përbashkët me CETEL, ka filluar përpara nënshkrimit të Kontratës, procedurën për të zvogëluar kapitalin aksionar të Albtelecom sh.a. në shumën prej 15 000 000 000 (pesëmbëdhjetë miliardë) lekë, të përbërë prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) aksione, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lekë secila, në bazë të vendimeve të Ministrit nr.419, datë 13.6.2007 dhe nr. 420, datë 15.6.2007;

d) CETEL është një shoqëri anonime e themeluar dhe e krijuar rregullisht sipas ligjeve të Republikës së Turqisë, që vepron me shoqërinë Turk Telekomunikasyon A.S. në bazë të një ortakërie dhe të një kontrate menaxhimi, me qëllim përfundimin e këtij transaksioni (që do të përcaktohet këtu më poshtë);

e) CETEL ka aftësi financiare për të kryer aktivitetin e Altelecomit dhe për të përmbushur detyrimet financiare sipas kësaj Kontrate dhe planit të biznesit, siç përcaktohet më poshtë, me anë të burimeve të veta financiare dhe me mbështetjen e Calik Holding A.S., siç deklarohet në letrën e angazhimit të lëshuar në favor të CETEL nga Calik Holding A.S. dhe në letrën e patronazhit që do të lëshohet nga Calik Holding A.S. dhe që do t'i dorëzohet Shitësit në mbyllje. Letra e angazhimit dhe letra e patronazhit përmendur këtu i bashkëngjiten kësaj Kontrate si shtojca P;

f) Në mbështetje të ligjit nr.8810, datë 17 maj 2001 për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime "Altelecom" sh.a., me ndryshimet përkatëse, ("Ligji për privatizimin") dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 416, datë 2 korrik 2004 Për përcaktimin e paketës së aksioneve, që do t'i ofrohet investitorëve strategjikë, Ministria shpalli një tender për shitjen e 76% (shtatëdhjetë e gjashtë për qindshit) të aksioneve të Altelekom-it, në një paketë të vetme, CETEL u shpall fitues me vendim të Këshillit të Ministrave nr.359, datë 26 maj 2005 për miratimin e raportit për vlerësimin e ofertave dhe shpalljen e fituesit të tenderit të hapur ndërkombëtar për privatizimin e Altelecom sh.a.;

g) Më datë 23 qershor 2005, Palët nënshkruan Kontratën për blerjen e aksioneve ("KBA") me qëllim transferimin e 76% (shtatëdhjetë e gjashtë për qindshit) të aksioneve të Altelecom-it në zotërim të Ministrisë të CETEL;

h) Megjithatë, për shkak të mospërmbushjes së kushteve paraprake që parashikoheshin në KBA, transaksionet e mbylljes që lidheshin me KBA nuk u përfunduan dhe si rrjedhojë e kësaj, Qeveria Shqiptare, në përputhje me vendimin nr.7, datë 13 tetor 2005 të Kuvendit të Shqipërisë, kërkoi ekspertizë ndërkombëtare lidhur me formën e KBA-së dhe vlefshmërinë e procedurave të ndjekura gjatë procesit të privatizimit;

i) Në vijim të sa më sipër, Shitësi rifilloi negociatat me CETEL-in për shitjen në një paketë të vetme të 11 400 000 (njëmbëdhjetë milionë e katërqind mijë) aksioneve të zakonshme të Shoqërisë, të lira nga çdo barrë, që përfaqësojnë 76% (shtatëdhjetë e gjashtë për qind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë, pas zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës c) të kushteve paraprake ("Aksionet në shitje"), dhe CETEL ka si qëllim të blejë aksionet në shitje, që aktualisht zotërohen nga Shitësi, nëpërmjet një shoqërie që do të krijohet për qëllim të këtij transaksioni dhe që do të deklarohet në datën e mbylljes (këtu e më poshtë "Shoqëria e Re"), në të cilën CETEL-i do të jetë direkt ose indirekt aksionari kontrollues, sipas rastit. Në çdo rast CETEL-i do të krijojë një ortakëri me Turk Telekomunikasyon A.S., siç përcaktohet në pikën d) të kushteve paraprake (në vijim "Ortakëria"), në mënyrë që Turk Telekomunikasyon A.S. do të zotërojë jo më pak se 20% (njëzet për qind) të kapitalit të kësaj ortakërie, e cila do të jetë pronare e vetme e Shoqërisë së Re.

Duke marrë parasysh sa më sipër, PALËT bien dakord si më poshtë vijon:

#### Neni 1 Përkufizime

Përveç, termave të tjera të përkufizuara ndryshe në këtë Kontratë, për qëllimet e saj, fjalët dhe termat që vijojnë do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

"Llogaritë"

do të thotë pasqyrat financiare të kontrolluara të Shoqërisë, të përgatitura në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në Shqipëri, për vitin ushtrimor të mbyllur në datën e fundit kontabël, siç rezulton në regjistrin e Zyrës së Tatimeve, Tiranë, dhe siç parashikohet në shtojcën M;

<p>“Kontratë”</p>	<p>do të thotë kjo kontratë për blerje aksionesh - duke përfshirë si pjesë përbërëse të saj, kushtet paraprake të mësipërme, si dhe shtojcat bashkëngjitur – nënshkruar dhe përfunduar nga dhe ndërmjet CETEL-it dhe Shitësit;</p>
<p>“Shteti Shqiptar”  “Licenca e Albtelekomit”-it</p>	<p>do të thotë Republika e Shqipërisë;  do të thotë licencat e Albtelekom-it që janë lëshuar nga ERT, bashkëngjitur këtu si shtojca C;</p>
<p>“Rrjeti i Albtelekomit”-it</p>	<p>do të thotë pajisjet dhe infrastruktura elektronike (p.sh. kablllo bakri, antena, fibra optikë) që Albtelekom-i përdor për aktivitetin e tij dhe që janë përfshirë në inventarin datë 20.3.2007, lista e të cilit bashkëngjitet si shtojca I;</p>
<p>“Afati i fundit i dorëzimit të ofertave”</p>	<p>do të thotë 6 maj 2005;</p>
<p>“Aktivitet”</p>	<p>do të thotë të gjitha shërbimet që Shoqëria i ofron klientëve të saj në bazë të licencave të Albtelecom dhe/ose të gjitha shërbimet që Eagle Mobile i ofron klientëve të saj në bazë të licencës së Eagle Mobile;</p>
<p>“Ditë pune”</p>	<p>nënkupton ditët, kur bankat janë të hapura për shërbime në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Turqisë;</p>
<p>“Plan Biznesi”</p>	<p>do të thotë plani i biznesit që CETEL-i përgatit dhe i paraqet Shitësit bashkë me ofertën e CETEL-it për blerjen e aksioneve në shitje, me ndryshimet përkatëse dhe bashkëngjitur kësaj Kontrate si shtojca L, që do jetë në fuqi dhe do të zbatohet në periudhën 2007 – 2011 për Albtelecom-in dhe Eagle Mobile, siç përcaktohet më poshtë;</p>
<p>“Mbyllja”</p>	<p>do të thotë blerja dhe shitja e aksioneve në shitje, regjistrimi i Blerësit, siç përcaktohet më poshtë, si aksionar i ri në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë, pagesa e çmimit të blerjes, dhe, në përgjithësi, nënshkrimi dhe shkëmbimi i të gjithë dokumenteve, si dhe zbatimi dhe përmbushja e të gjitha detyrimeve, që duhet të përfundohen dhe nënshkruhen, përkatësisht në datën e mbylljes, në përputhje me këtë Kontratë, me qëllim që Blerësi, siç përcaktohet më poshtë, të bëhet pronari i ligjshëm i aksioneve në shitje;</p>
<p>“Data e mbylljes”</p>	<p>do të thotë data kur kryhet mbyllja, në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate. Data e mbylljes, do jetë në çdo rast, në ditën e fundit të muajit, brenda të cilit të gjitha kushtet që përcaktohen në nenin 10 të Kontratës do të jenë përmbushur para kësaj date, dhe vetëm nëse këto kushte do të jenë përmbushur brenda datës 15 të muajit të lartpërmendur. Në rast se data, në të cilën përmbushen të gjitha kushtet siç përcaktohet në</p>



	<p>nenin 10 të Kontratës, përkon me një datë pas ditës së 15 të muajit, data e mbylljes do të jetë në ditën e fundit të muajit kalendarik pasardhës. Pavarësisht nga sa më lart, me marrëveshje me shkrim të Palëve, data e mbylljes mund të caktohet në një ditë tjetër.</p>
“Kodi Tregtar”	do të thotë ligji nr.7638, datë 19 nëntor 1992 për shoqëritë tregtare, me ndryshimet përkatëse;
“Konsulentët”	do të thotë këshilltarët e Shitësit në transaksion, përkatësisht Banka IMI S.p.A., Bain & Company Italy dhe Tonucci & Partners – Associazione Professionale;
“Data room”	do të thotë data room-i fizik i Albetelekom-it, hapur në datat 22 – 24 mars 2005, dhe data room-i elektronik ( <i>on-line</i> ) i hapur nga data 19 mars 2005 deri ne afatin e fundit të dorëzimit të ofertave, ku një seri dokumentesh të ndryshme në kuadrin e <i>due diligence</i> për Shoqërinë dhe për Eagle Mobile, i janë vënë në dispozicion për shqyrtim ofertuesve për transaksionin (“Data room 1”) dhe data room – i fizik i rihapur në datat 4-8 Dhjetor 2006 (“Data room 2”), si dhe dokumentacioni shtesë i dorëzuar CETEL-it nga Shoqëria dhe konsulentët me qëllim nënshkrimin e kësaj Kontrate, (të gjitha së bashku “Data room”), si dhe një listë e azhurnuar dhe e detajuar e data room, që i referohet qartë dokumenteve të data room-it, dhe që i bashkëngjitet Kontratës si shtojca N; dokumentet e data room-it do t’i jepen CETEL-it në 31 (tridhjetenjë) dosje të veçanta të nënshkruara dhe të vulosura nga Shoqëria;
“Parapagim”	do të thotë shuma prej 2 908 527 (dy milionë nëntëqindetë mijë e pesëqind e njëzet e shtatë) euro që Blerësi siç përcaktohet më poshtë, paguan në datën e mbylljes, sipas parashikimeve të nenit 3, numri 1 i Kontratës. Shuma, në përputhje me vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit, datë 31.3.2006 përbëhet nga (i) 2 274 000 (dy milionë e dyqind e shtatëdhjetë e katër mijë) euro, si tarifë suksesi për privatizimin e Albtelecom-it; (ii) 568 288 (pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) euro, si një pjesë e mbetur e tarifës së suksesit për privatizimin e AMC sh.a.; (iii) 66 239 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e tridhjetë e nëntë) euro, si shpenzime arbitrazhi;
“Eagle Mobile”	do të thotë Eagle Mobile sh.a., një shoqëri anonime, aksionet e të cilës zotërohen 100 % (njëqind për qind) nga Albtelecom-i, pa asnjë pretendim nga palë të treta, dhe e themeluar nga Albtelekom-i në bazë të vendimit të Gjykatës, Tiranë nr.30436, datë 24 tetor 2003, për të operuar

“Licenca e Eagle Mobile”	në tregun e telekomunikacioneve të telefonisë së lëvizshme; do të thotë licenca e Eagle Mobile lëshuar nga ERT-ja më datë 1 mars 2004, bashkëngjitur kësaj Kontrate si shtojca C;
“Barrë”	do të thotë çdo hipotekë, detyrim, peng, garanci, e drejtë zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta për t’u ofruar i pari në blerje, e drejta ose interesi i një pale të tretë, barrë ose interesa siguruese të çdo lloji, ose çdo lloj tjetër marrëveshjeje preferenciale (duke përfshirë, por pa u kufizuar në transferimin e një titulli ose të një marrëveshjeje kontrolluese) me efekte të ngjashme;
“Ortakëri”	do të thotë ortakëri në kapitalin e një personi juridik ndërmjet CETEL dhe Turk Telekomunikasyon A.S. me qëllim për të hyrë në këtë transaksion;
“Forca madhore”	do të thotë çdo urdhër, rregullore ose direktivë qeveritare, e botuar në formën e ligjit, ose ndryshe, apo çdo sanksion i natyrës kombëtare ose ndërkombëtare, kryengritje, grevë, demonstrata, trazira civile, luftë (e deklaruar ose jo), veprime apo kërcënime për veprime terroriste, apo grupe guerilase apo individë, zjarre, përmbytje, tërmete, greva, mbyllje e bizneseve, apo shkaqe të tjera jo për faj të, apo nga pakujdesia e Palëve, ose të secilës prej tyre, të ngjashme ose jo me sa më sipër, me kusht që këto shkaqe të jenë jashtë kontrollit të Palës së cenuar;
“Miratimet qeveritare”	do të thotë të gjitha miratimet, pëlqimet, lejet, dhe licencat, që duhen marrë nga autoritet qeveritare sipas rastit;
“Autoriteti qeveritar”	do të thotë çdo gjykatë vendase ose e huaj, ose çdo autoritet tjetër gjyqësor ose qeveritar, administrativ ose organ rregullator, departament, agjenci, komision, autoritet, ose instrument;
“Garancia fillestare”	do të thotë garancia që CETEL-i dorëzon në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, dhe që i bashkëngjitet kësaj Kontrate si shtojca O, në vlerën prej 10 % (dhjetë për qind) të çmimit të blerjes;
“Data e fundit kontabël”	do të thotë 31 dhjetor 2006;
“Letra e patronazhit”	do të thotë letra që do t’i dërgohet Shitësit nga Calik Holding A.S., në formën që paraqitet në shtojcën P, bashkëngjitur kësaj Kontrate, ku deklarohet se Calik Holding A.S. në cilësinë e shoqërisë kryesore memë të Blerësit, siç përcaktohet më poshtë, do të mbështesë dhe mbikëqyrë përbushjen e detyrimeve financiare që parashikon kjo Kontratë për Blerësin, siç përcaktohet më poshtë, për një periudhë 5-vjeçare duke filluar nga mbyllja;

“Letra e angazhimit”	do të thotë letra bashkëngjitur kësaj Kontrate, si shtojca P, në të cilën shoqëria aksionare e të drejtës turke Calik Holding A.S., në cilësinë e shoqërisë kryesore mëmë të CETEL, merr përsipër çdo dhe të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë, veçmas dhe solidarisht me CETEL, në periudhën ndërmjet nënshkrimit dhe mbylljes;
“Licencat”	do të thotë licencat e Albtelecom-it dhe të Eagle Mobile, të bashkëngjitura këtu si shtojca C;
“Humbje” ose “Humbjet”	do të thotë çdo dëm, kosto, shpenzime të kryera, pagesa, humbje ose detyrime, në shumën jo më pak se 30,000 euro (tridhjetë mijë) secila nga këto, dhe 350, 000 euro (treqindpesëdhjetë mijë) në total, të cilat janë pasojë direkte dhe/ose indirekte e shkeljes së deklarimeve dhe garancive që përcaktohen në nenin 5;
“Materiale”	(dhe variacionet e saj) do të thotë, në lidhje me një ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, se kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht – veçmas ose së bashku – ka një ndikim thelbësor dhe/ose ndikim përkeqësues në gjendjen ekonomike, pasurore, financiare, tregtare dhe në perspektivën e Shoqërisë dhe/ose veprimet e saj në tërësi, në mënyrë të tillë që vendimi për kryerjen e transaksionit mund të ishte ndryshe në rast se Blerësi, siç përcaktohet më poshtë, do të kishte dijeni për këtë ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht, apo kur kjo ngjarje, rrethanë, fakt ose kusht mund të shkaktonte një ndryshim material përkeqësues.
“Ndryshim material përkeqësues”	do të thotë një nga ngjarjet, që ndodh në periudhën midis datës së fundit kontabël dhe datës së mbylljes, si më poshtë vijon: a) vendim i autoriteteve kompetente shqiptare që heqin, anulojnë, pezullojnë apo ndryshojnë licencat, të cilat ndikojnë që Shoqëria të mos kryejë aktivitetin e saj siç e kryen zakonisht; b) vendim i formës së prerë i një gjykate ose autoriteti shtetëror që deklaroi se Shoqëria apo Eagle Mobile kanë falimentuar, ose nuk kanë aftësi paguese; c) fillimi i procedurave të likuidimit të Shoqërisë dhe Eagle Mobile, nga vetë shoqëritë; d) çdo ngjarje ose seri ngjarjesh, që linden si rezultat i administrimit apo veprimeve të Shoqërisë ose të Eagle Mobile, të cilat përfshijnë një pagesë apo humbje që, veç e veç ose së bashku, arrijnë shumën prej jo më pak se 500,000 (pesëqind mijë) euro; e) çdo kufizim ose pengesë në ushtrimin e të

	drejtave të Shoqërisë mbi tokën, të cilat nuk lejojnë që Shoqëria të zhvillojë aktivitetin e saj të zakonshëm tregtar siç po e kryen tani;
	f) çdo vendim gjykate, masë provizore, që ndalon Shoqërinë ose Eagle Mobile të zhvillojë aktivitetin e saj të zakonshëm.
“Shoqëri e Re”	ka kuptimin që përcaktohet në pikën (i) të kushteve paraprake;
“Pala” ose “Palët”	do të thotë Blerësi, siç përcaktohet më poshtë, ose Shitësi ose të dy së bashku, siç e kërkon përmbajtja;
“Ligji për privatizimin”	Ligji nr. 8810, datë 17 Maj 2001 për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime Albtelecom sh.a.;
“Çmimi i blerjes”	do të thotë çmimi që Blerësi, siç përcaktohet më poshtë, i paguan Shitësit për blerjen e aksioneve në shitje, siç përcaktohet në nenin 3 dhe në përputhje me mekanizmin e përcaktuar po aty;
“Deklarata për çmimin e blerjes”	do të thotë deklarata e shkruar, në formën e rënë dakord në shtojcën A, e nënshkruar nga nëpunësi përkatës i çdo banke të caktuar nga Blerësi, siç përcaktohet më poshtë, që vërteton se, çmimi i blerjes është derdhur në llogaritë bankare që përcaktohen, sipas parashikimeve të nenit 3;
“Blerësi”	do të thotë CETEL-i ose Shoqëria e Re, që zotërohet nga ortakëria, sipas rastit;
“Aksione në shitje”	do të thotë një numër prej 11 400 000 (njëmbëdhjetë milionë e katërqindmijë) aksione të zakonshme, plotësisht të paguara të Shoqërisë, me vlerë nominale prej 1 000 (njëmijë) lekë secili, të barabartë me 76 % (shtatëdhjetë e gjashtë për qind) të kapitalit aksionar të Shoqërisë. Aksionet në shitje përfaqësohen nga certifikata sipas formës së bashkangjitur si shtojca B;
“Nënshkrimi”	do të thotë nënshkrimi i kësaj Kontrate;
“Ligji për telekomunikacionet”	do të thotë ligji shqiptar për telekomunikacionet, nr.8618, datë 16 qershor 2000, me ndryshimet përkatëse;
“Transaksion”	do të thotë shitja e paketës prej 76% (shtatëdhjetë e gjashtë për qind) të aksioneve të Shoqërisë në përputhje me ligjin për privatizimin, me ndryshimet përkatëse, dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nr.416, datë 2 qershor 2004 për përcaktimin e paketës së aksioneve që do t`i ofrohet investitorëve strategjikë;
“Dokumentet e transaksionit”	do të thotë kjo Kontratë, garancia fillestare, letra e angazhimit dhe letra e patronazhit sipas rastit, dhe çdo ndryshim tjetër ose shtojcë bashkëngjitur atyre;
“ERT”	do të thotë Enti Rregullator i Telekomunikacioneve të Shqipërisë;

1.1. Fjalët në gjininë mashkullore do përfshijnë gjininë femërore dhe neutro dhe fjalët në njëjës do përfshijnë shumësin dhe anasjelltas.

1.2. "Person" përfshin çdo person juridik, organizatë të përgjithshme dhe ortakëri (nëse kanë ose jo personalitet juridik më vete).

1.3 Referencat në këtë Kontratë për nenet dhe shtojcat nënkuptojnë nenet dhe shtojcat e kësaj Kontrate (përveçse kur konteksti parashikon ndryshe). Shtojcat e kësaj Kontrate përbëjnë pjesë integrale të saj.

1.4 Titujt në këtë Kontratë janë vendosur vetëm për lehtësi referimi dhe nuk do të ndikojnë në interpretimin e saj.

1.5 Çdo klauzolë e detyrueshme e kësaj Kontrate, për më shumë se një person, përveçse kur parashikohet ndryshe, është e detyrueshme për secilin prej tyre veç e veç ose së bashku.

1.6 Referencat për likuidimin e një personi përfshin shkrirje, prishje, falimentim, likuidim ose bashkim të këtij personi dhe çdo procedurë të ngjashme apo analoge në përputhje me legjislacionin e juridiksionit në të cilin ky person është krijuar, ka adresën apo selinë, ose ushtron aktivitetin apo zotëron pasuri.

1.7 Referimi për librat e llogarisë, procesverbale apo informacione të tjera nënkupton librat e llogarisë, procesverbale ose informacion tjetër të çdo forme duke përfshirë letër, të dhëna të regjistruara në mënyrë elektronike, në shirit, film ose mikrofilm.

## Neni 2

### **Blerja e aksioneve në shitje**

Sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate, në datën e mbylljes, Shitësi do t'i shesë Blerësit dhe Blerësi do të blejë nga Shitësi, aksionet në shitje dhe çdo të drejtë që lidhet me to, të lira nga çdo barrë, me një vlerë të barabartë me shumën e përcaktuar në nenin 3 dhe të pagueshme, sipas mënyrës që përcaktohet po aty.

Mbyllja e transaksionit që parashikohet në këtë Kontratë e që do kryhet në datën e mbylljes, do të zhvillohet pranë zyrave të Shitësit.

## Neni 3

### **Çmimi i blerjes dhe mënyra e pagesës**

Çmimi total i blerjes së aksioneve në shitje është 120 000 000 (njëqind e njëzet milionë) euro, (në vijim "Çmimi i blerjes") dhe do të paguhet në përputhje me këtë nen sipas kushteve dhe afateve të kësaj Kontrate.

Të drejtat e Blerësit mbi dividendin për çdo aksion në shitje do të maturohen duke filluar nga data e mbylljes.

Blerësi, do t'i paguajë shitësit çmimin total të blerjes, si më poshtë vijon:

1. në datën e mbylljes, parapagimi do të kryhet nga Blerësi, me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse të Banca IMI S.p.A, Swift Code IMITITMM, ABI 3086, CAB 1600, si tarifë suksesi për ofrimin e shërbimeve këshilluese nga konsulenti, që përfshihet në çmimin total të blerjes;

2. në datën e mbylljes, çmimi i blerjes minus parapagimin, do të paguhet nga Blerësi te Shitësi, me transfertë bankare në llogarinë rrjedhëse që Shitësi i komunikon Blerësit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para datës së mbylljes.

## Neni 4

### **Nënshkrimi dhe mbyllja**

4.1. Menjëherë pas nënshkrimit, çdo Palë do të fillojë punët përgatitore për të organizuar rregullisht mbylljen dhe për të përbushur të gjithë kushtet paraprake që parashikohen në këtë Kontratë. Palët pranojnë që garancia e ofertës që i është dorëzuar më parë Shitësit, në lidhje me shpalljen e fituesit të ofertës për blerjen e aksioneve në shitje i është kthyer Blerësit në ditën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në shkëmbim të dorëzimit të garancisë fillestare dhe letrës së angazhimit, bashkëngjitur kësaj Kontrate si shtojca P. Palët bien dakord që kjo Kontratë është një marrëveshje me kusht, dhe kushti është ndodhja e Mbylljes.

4.2. Mbyllja do të realizohet në datën e mbylljes pranë zyrave të Shitësit në Tiranë, apo në një vend, datë, orë tjetër, siç do përcaktohet me marrëveshje të përbashkët nga Palët.

4.3. Në Datën e mbylljes:

a) Shitësi:

1. do të dorëzojë certifikatat që përfaqësojnë aksionet në shitje, të cilat duhet të jenë lëshuar dhe përgatitur para datës së mbylljes, të nënshkruara rregullisht në favor të Blerësit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar;

2. do të nënshkruajë dhe dorëzojë dhe/ose të bëjë të mundur nënshkrimin dhe dorëzimin e dokumenteve të tjera të nevojshme sipas legjislacionit shqiptar, në mënyrë që t'i kalojë Blerësit një titull të mirë dhe të tregtueshëm mbi aksionet në shitje dhe për të përmbushur siç duhet qëllimin e kësaj Kontrate, përfshirë noterizimin e saj;

3. do të bëjë të mundur dorëheqjen e të gjithë anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, të Drejtorisë të Shoqërisë dhe të Eagle Mobile, si dhe të ekspertëve kontabël të Shoqërisë dhe të Eagle Mobile nëpërmjet paraqitjes së letrave të dorëheqjes së tyre pranë Shoqërisë dhe Eagle Mobile, dhe të caktojë në pozicionet e tyre, personat e propozuar nga Palët dhe të zgjedhur në përputhje me paragrafin e parafundit të nenit 4.3, të cilët do të jenë në këto detyra që nga data e mbylljes, nëpërmjet thirrjes së asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë dhe të Eagle Mobile në datën e mbylljes dhe dorëzimit të Blerësit të vendimeve të asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë dhe të Eagle Mobile;

4. t'i kthejë Blerësit garancinë fillestare dhe letrën e angazhimit;  
dhe

b) Blerësi do t'i dorëzojë Shitësit dokumentet e mëposhtme:

1. Ddeklaratën e çmimit të blerjes, në shumat e përcaktuara në nenin 3, pika 1 dhe 2;

2. një ekstrakt nga regjistri tregtar për Blerësin, të lëshuar brenda 10 (dhjetë) ditëve pune para mbylljes;

3. një certifikatë të noterizuar që vërteton gjendjen e mirë financiare të Blerësit;

4. një kopje të noterizuar të vendimit të organeve kompetente të Blerësit, që miraton blerjen e aksioneve në shitje;

5. Letra e patronazhit;

6. një opinion ligjor të këshilltarit ligjor të Blerësit, në formë të pranueshme për Shitësin, që konfirmon autoritetin e Blerësit, për lidhjen e kësaj Kontrate dhe përmbushjen e detyrimeve të tij që rrjedhin nga kjo Kontratë.

Në Datën e mbylljes, Blerësi do të fitojë titullin mbi aksionet në shitje dhe Shitësi po në këtë datë do të regjistrojë Blerësin në regjistrin e aksioneve të Shoqërisë. Blerësi do të përfitojë çdo dividend të deklaruar ose të paguar, si dhe do të gëzojë të gjitha të drejtat e tjera që lidhen me to, duke filluar nga data e mbylljes. Në datën e mbylljes, Shitësi do të mundësojë thirrjen e mbledhjes së aksionarëve të Shoqërisë, me rend dite që do të përcaktohet me marrëveshje me Blerësin përpara datës së mbylljes dhe do të përfshijë – ndër të tjera – emërimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar në vend të atyre që kanë dhënë dorëheqjen. Përsa kohë që Shitësi do të zotërojë së paku 10 % (dhjetë për qind) të aksioneve të Albtelecom-it dhe në asnjë rast jo më shumë se 5 (pesë) vjet, Shitësi ka të drejtë, të përcaktojë emrin e 1 (një) anëtari të Këshillit Mbikëqyrës, ndërsa Blerësi ka të drejtë të përcaktojë emrat e anëtarëve të tjerë të Këshillit Mbikëqyrës, pa u kufizuar, nëse ka, në dispozitat e Kodit Tregtar, si dhe në dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme. I njëjti proces do të zbatohet dhe për Eagle Mobile.

Kur të kryhet mbyllja, të gjitha veprimet e mbylljes do të konsiderohen se kanë ndodhur në të njëjtën kohë në datën e mbylljes dhe asnjë transferim ose dorëzim nuk do të quhet i përfunduar deri sa të gjitha veprimet e mbylljes të kenë përfunduar, siç parashikohet në këtë nen 4.3.

## Neni 5

### **Deklarimet dhe garancitë e Shitësit**

Shitësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton në lidhje me Shoqërinë dhe me Eagle Mobile, si dhe me transaksionin që parashikohet në këtë Kontratë, për të gjitha çështjet që vijnë

deri në datën e nënshkrimit të saj. Shitësi, gjithashtu deklaron dhe garanton se ka vënë në dispozicion të gjithë informacionin përkatës për Shoqërinë dhe Eagle Mobile për qëllimet e transaksionit.

Shitësi, gjithashtu garanton se çdo garanci dhe deklarim do të jetë i vërtetë, i saktë dhe jo i keqpërdorur në datën e mbylljes.

#### 5.1 ORGANIZIMI

Shoqëria dhe Eagle Mobile janë krijuar dhe themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk janë në gjendje paaftësie paguese apo në falimentim, dhe kanë fuqi të plotë dhe kompetenca për të kryer aktivitetin e tyre siç i kryejnë aktualisht, si dhe të zotërojnë asete dhe prona siç i zotërojnë aktualisht. Shoqëria dhe Eagle Mobile operojnë me licenca të vlefshme, me ndryshimet përkatëse siç përcaktohet në shtojcën C, nuk kanë shkelur asnjë prej afateve të këtyre licencave dhe nuk kërkohet asnjë licencë tjetër që këto shoqëri të kryejnë aktivitetin e tyre, siç e zhvillojnë aktualisht.

#### 5.2 AUTORIZIMI

Pavarësisht nga sa parashikohet në nenin 10.1 të Kontratës, të gjitha aktet ligjore dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Shitësit dhe që autorizojnë Shitësin të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht; kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Shitësi dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Shitësin dhe që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

#### 5.3 MUNGESA E KONFLIKTEVE

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate, si dhe përfundimi i transaksionit që parashikohet në këtë Kontratë dhe përmbushja e kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj Kontrate nga Shitësi nuk janë dhe nuk do të jenë në konflikt, ose nuk do të rezultojnë në ndonjë shkelje apo mospërmbushje, ose nuk do të mundësojnë krijimin e ndonjë të drejte për përfundimin, anulimin, ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje të ndonjë përfitimi material, ose nuk do të krijojnë ndonjë barrë mbi çdo aktivitet, aset ose pronë të Shitësit, sipas dispozitave të një vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të detyrueshme për Shitësin.

#### 5.4 PRONËSIA

Shitësi është pronari dhe përfituesi i vetëm dhe i ligjshëm i aksioneve në shitje, në një total prej 11 400 000 (njëmbëdhjetë milionë katërqind mijë) aksione, që përbën numrin e aksioneve në shitje pas zvogëlimit të kapitalit, dhe deklaron dhe garanton si aksionari i vetëm i Shoqërisë se Shoqëria është pronari dhe përfituesi i vetëm dhe i ligjshëm i të gjitha aksioneve që përbëjnë kapitalin Eagle Mobile, në një total prej 157 483 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e katërqind tetëdhjetë e tre) aksione.

Aksionet në shitje janë të përcaktuara dhe të emetuara rregullisht, si dhe janë paguar plotësisht. Shitësi deklaron dhe garanton në cilësinë e aksionarit të vetëm të Shoqërisë se aksionet e Eagle Mobile janë të përcaktuara dhe të emetuara rregullisht, si dhe janë paguar plotësisht.

Aksionet në shitje janë të lira dhe të çliruara nga çdo barrë e çfarëdo lloji dhe Shitësi ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar aksionet në shitje në përputhje me afatet e kësaj Kontrate.

Shitësi, më tej, deklaron dhe garanton në cilësinë e aksionarit të vetëm të Shoqërisë se të gjitha aksionet e Eagle Mobile janë të lira dhe të çliruara nga çdo barrë e çfarëdo lloji, si dhe nga pretendimet dhe se Shitësi në cilësinë e aksionarit të vetëm të Shoqërisë ka të gjitha të drejtat, kompetencën dhe autorizimin e plotë për t'i shitur, për t'i kaluar, transferuar dhe dorëzuar aksionet e Eagle Mobile, në përputhje me afatet e kësaj Kontrate.

Nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që krijon ose vendos ndonjë barrë në lidhje me aksionet në shitje ose me aksionet e Eagle Mobile, ose ndonjë numër aksionesh të autorizuar por të paemtuara në kapitalin e Shoqërisë. Asnjë person nuk pretendon se ka ndonjë të drejtë mbi

ndonjë barrë lidhur me ndonjë nga aksionet në shitje ose aksionet e Eagle Mobile.

Përveç kësaj Kontrate, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që parashikon krijimin, dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien e të drejtës një personi (të kushtëzuar ose jo) për të kërkuar dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni të kapitalit të Shoqërisë (që përfshin, por pa u kufizuar në, një preferencë - të drejtën për të ofruar i pari ose të drejtën e parablerjes ose këmbim). Shitësi deklaron dhe garanton në cilësinë e aksionarit të vetëm të Shoqërisë se, nuk ka asnjë kontratë, marrëveshje, ose detyrim që kërkon krijimin, dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin, ose dhënien e së drejtës një personi (të kushtëzuar ose jo) për të kërkuar dhënien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonjë aksioni në kapitalin e Eagle Mobile (që përfshin, por pa u kufizuar në, një preferencë - të drejtën për të ofruar i pari ose të drejtën e parablerjes ose këmbim).

#### 5.5 FILIALET

Shoqëria zotëron 100 % (njëqind për qind) të aksioneve të Eagle Mobile sh.a. dhe, në cilësinë e aksionarit të vetëm, ka autorizimin e duhur për të shitur, transferuar dhe dorëzuar çdo dhe të gjitha aksionet e Eagle Mobile, pa asnjë kufizim.

#### 5.6 LLOGARITË

Llogaritë e Shoqërisë të datës së fundit kontabël - që i janë vënë në dispozicion Blerësit dhe që bashkëngjiten këtu si shtojca M - janë përgatitur në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në Shqipëri. Shitësi, më tej, deklaron dhe garanton se llogaritë e kontrolluara të Eagle Mobile për vitet ushtrimore 2005, 2006 bashkëngjitur Kontratës si shtojca M, janë përgatitur gjithashtu në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me parimet e përgjithshme të kontabilitetit të pranuar në Shqipëri.

#### 5.7 REGJISTRAT KONTABËL DHE LIBRA TË TJERË TË SHOQËRISË

Regjistrat kontabël dhe librat e Shoqërisë dhe të Eagle Mobile, janë të azhuruara, në zotërim ose nën kontrollin e këtyre shoqërive dhe mbahen në mënyrën e duhur dhe të gjitha regjistrimet në këto regjistra dhe libra kontabël janë mbajtur rregullisht dhe në përputhje me ligjet shqiptare dhe me standardet, parimet dhe praktikat e zbatueshme të vendit.

#### 5.8 MUNGESA E NDRYSHIMEVE MATERIALE

Aktiviteti i Shoqërisë është zhvilluar normalisht në mënyrë që të mbahet si një aktivitet i vazhdueshëm; dhe nuk ka ndodhur asnjë ndryshim material (thelbësor) në përmbajtjen, strukturën dhe vlerën e asetëve, si dhe të detyrimeve siç tregohet në llogaritë, si dhe nuk ka ndodhur asnjë zbritje materiale e vlerës së aktiveve neto të trupëzuara të Shoqërisë, (përveç rastit të amortizimit të zakonshëm dhe të zhvlerësimit) në bazë të vlerësimit të përdorur në llogaritë. Që nga data e fundit kontabël, Shoqëria është administruar dhe ka funksionuar në mënyrën e duhur dhe Shoqëria:

- nuk ka lidhur asnjë marrëveshje, vlera e së cilës kalon 100 000 (njëqind mijë) euro, me përjashtim të atyre që tregohen në shtojcën D; ose
- nuk i është ngarkuar asnjë detyrim material, nuk ka pësuar asnjë përgjegjësi materiale, ose ndryshim material përkeqësues; ose
- nuk ka ndërmarrë asnjë veprim tjetër, i cili mund të shkaktojë që çdonjëri prej deklarimeve dhe garancive të Shitësit që parashikohet në këtë Kontratë, të bëhet e pavërtetë ose e parregullt.

As Shoqëria dhe as Eagle Mobile që nga data e fundit kontabël:

a) nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim material përkeqësues lidhur me asetet, pronat ose aktivitetet e tyre të biznesit;

b) nuk kanë pësuar asnjë ngjarje ose rrethanë materiale në lidhje me asetet, biznesin ose pronat që rrezikon materialisht të ndërpresë, pengojë, dëmtojë ose përndryshe të cenojë materialisht dhe në mënyrë përkeqësuese rezultatin e veprimtarive të tyre në tërësi;

c) nuk kanë nënshkruar asnjë transaksion ose kontratë, ose hapur ndonjë procedurë prokurimi, përveç atyre të përcaktuara në shtojcën R; ose nuk kanë ndryshuar ose përfunduar ndonjë



transaksion ose kontratë, vlera e të cilëve kalon shumë prej 100 000 (njëqind mijë) euro dhe që mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues në asetet, pronat dhe aktivitetet e biznesit të Shoqërisë dhe Eagle Mobile;

d) nuk kanë shitur, transferuar, vënë peng, dhënë me qira ose përndryshe disponuar ndonjë aset ose pronë që zotëron Shoqëria apo Eagle Mobile;

e) nuk kanë punësuar personel ose nuk kanë rritur shkallën e kompensimit të pagueshëm ose për t'u paguar ndaj punonjësve, përveç rritjes sipas praktikave të mëparshme dhe në përputhje me çdo shpërblim aktual ose me plane të tjera, ose nuk kanë ndryshuar organizimin e punës në ndonjë mënyrë materiale;

f) nuk kanë fituar ose marrë me qira ndonjë pasuri të paluajtshme ose nuk kanë bërë ndonjë shpenzim kapitali (të trupëzuar ose të patrupëzuar) që kalon shumë prej 100 000 (njëqind mijë) euro;

g) nuk kanë fituar ose disponuar, në çfarëdo lloji forme, interesa në kapitalin e shoqërive të tjera ose nuk kanë fituar, disponuar ose hyrë në marrëdhënie qiraje (si qiramarrës ose qiradhënës) për ndonjë aktivitet apo për ndonjë pjesë aktivitetit;

h) nuk kanë deklaruar ose paguar asnjë dividend me përjashtim të shumës prej 3 875 347 981 (tre miliardë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e treqind e dyzet e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë, që përbën dividendin e shpërndarë të Shoqërisë, për vitin 2006, ose nuk kanë blerë ose përndryshe nuk kanë fituar ndonjë interes në kapitalet e tyre;

i) nuk kanë hyrë në, rritur, ose shtuar ndonjë detyrim në lidhje me ndonjë garanci ose dëmshpërblim, ose tjetër jashtë zhvillimit normal të aktivitetit të tyre;

j) nuk kanë vonuar pagesa, ndryshuar fatura, dhe ristrukturuar pagesa, ose kushtet e pagesave apo të tjera ndryshe nga praktikat e mëparshme të zbatueshme të biznesit;

k) nuk kanë paguar, likuiduar apo përmbyshur ndonjë pretendim, përgjegjësi ose detyrim jashtë ushtrimit normal të biznesit të tyre;

l) nuk kanë rënë dakord për të kryer sa përmendet më lart.

#### 5.9 TAKSA DHE KONFLIKTET

Shoqëria dhe Eagle Mobile kanë depozituar në kohën e duhur, të gjitha deklaratat periodike dhe vjetore fiskale që parashikohen nga legjislacioni fiskal i zbatueshëm në lidhje me to. Këto deklarata tatimore janë përgatitur rregullisht dhe të gjitha detyrimet tatimore direkte ose indirekte të pagueshme, janë paguar plotësisht dhe në kohë. Për sa më sipër, autoritetet tatimore shqiptare do të lëshojnë raporte të plota kontrolli tatimor për Shoqërinë edhe për Eagle Mobile, për periudhën që përfshin vitet 2004 dhe 2005 deri në datën e fundit kontabël, siç përcaktohet në shtojcën Q.

Nuk ka asnjë konflikt gjyqësor në proces ose konflikt të mundshëm për t'u kthyer në proces gjyqësor në lidhje me Shoqërinë ose Eagle Mobile, me përjashtim të atyre që përcaktohen në shtojcën F.

As Shoqëria dhe as Eagle Mobile nuk janë në proces hetimi dhe procedimi nga ERT-ja ose Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, si pasojë e të cilave mund të vendoset një gjobë mbi ndonjë çështje rregullatore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, tarifën e sigurimit, tarifën, marrëdhëniet midis degëve, detyrimet e interkonjeksionit, detyrimet përkundrejt operatorëve të tjerë të telefonisë së lëvizshme, operatorët ruralë, operatorët me kartë të parapaguar etj.

#### 5.10 AKTIVET E TRUPËZUARA

Shoqëria ka titull pronësie të plotë, të mirë, të regjistruar dhe të tregtueshëm mbi të gjitha asetet dhe pronat e saj, që pasqyrohen në llogaritë e datës së fundit kontabël apo që janë fituar pas kësaj date, siç tregohet në shtojcat G dhe H dhe I dhe ky titull nuk është objekt i ndonjë kufizimi, hipoteke, pengu, barre, detyrimi ose të drejte të çfarëdo lloji në përfitim të palëve të treta.

Rrjeti i Albtelecom-it, siç përcaktohet në listën e inventarëve, datë 20.3.2007, që i bashkëngjitet Kontratës si shtojca I, është në pronësi të Albtelecom-it dhe, si rrjedhojë menaxhimi i këtij rrjeti do të kryhet nga Albtelecom-i. Albtelecom-i, do t'i japë operatorëve të tjerë të telekomunikacionit, të drejtë aksesit për kapacitetet e lira të tubave, sipas parashikimeve të legjislacionit shqiptar të zbatueshëm dhe rregulloret e TRE në përputhje me direktivat europiane.

Në lidhje me rrjetin që përdoret nga Albtelecom-i dhe që nuk është pronë e Shoqërisë, Albtelecom-it i jepet e drejta e përdorimit falas deri në momentin e mbarimit të afatit të licencave të

Albtelekomit.

#### 5.11 AKTIVET E PATRUPËZUARA

Shoqëria është pronarja e vetme dhe ekskluzive – ose ka të drejtë të përdorë – markat tregtare, patentat, emrat tregtarë, njohuri teknike (*know-how*) të saj si dhe çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj, (“Aktivet e patrupëzuara”), siç tregohen në shtojcën J, dhe nuk është në shkelje të asnjë prej aktiveve të patrupëzuara të saj.

Shoqëria është licencuar rregullisht për përdorimin e *software-ve* të saj.

Këto aktive të patrupëzuara janë plotësisht të përdorshme nga ana e Shoqërisë pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë licence, tarife, rentë (*royalty*), ose ndonjë detyrimi tjetër të ngjashëm.

Eagle Mobile është pronarja e vetme dhe ekskluzive – ose ka të drejtë të përdorë – e markave tregtare, patentave, e emrave tregtarë, njohurive teknike (*know-how*) dhe e çdo të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale të saj, të nevojshme për kryerjen e aktivitetit të saj, siç tregohet në shtojcën J, dhe nuk ka cenuar asnjë markë tregtare, patentë, emër tregtar, dhe njohuri teknike (*know-how*) dhe asnjë të drejtë tjetër të pronësisë industriale ose intelektuale, pa qenë nevoja për pagimin e ndonjë tarife apo rente (*royalty*) për të përdorur këto.

#### 5.12 PUNONJËSIT

Të gjithë punonjësit e Shoqërisë janë të regjistruar rregullisht në librat dhe regjistrat përkatës, bashkë me shpërblimet në total që i paguhen secilit prej tyre, në përputhje me ligjet dhe rregulloret e zbatueshme. Në ditën e nënshkrimit, Shoqëria ka një numër total prej 2233 (dymijë dyqind e tridhjetë e tre) punonjës, ndërsa Eagle Mobile ka një numër total prej 29 (njëzetë nëntë) punonjës.

Shoqëria ka bërë të gjitha depozitimet dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet që duhen kryer apo të ndërmerren sipas ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme për sigurimet shoqërore, për marrëdhëniet e punës dhe mirëqenien për secilin nga punonjësit, përfshirë këtu, për shmangien e çdo dyshimi, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.495, datë 14.8.2001 për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë si rezultat i ristrukturimit të Albtelecom sh.a.. Të gjitha detyrimet për sigurimet shoqërore dhe mirëqenien në bazë të ligjeve dhe rregullore të zbatueshme, si dhe të kontratës kolektive, nëse ka, janë paguar plotësisht, siç tregohet në shtojcën E.

Çdo anëtar i Këshillit Mbikëqyrës, anëtar i drejtorisë ose çdo ekspert kontabël i Shoqërisë dhe Eagle Mobile dhe çdo punonjës ka marrë në vitin e fundit financiar vetëm shumat e paraqitura në llogaritë dhe asnjë prej tyre nuk ka të drejtë të marrë ndonjë shumë tjetër, përveç atyre që tregohen në këto llogari.

#### 5.13 PAJTUESHMËRIA ME LIGJIN

Shoqëria nuk ka shkelur asnjë statut, ligj, rregull, rregullore, urdhër, dekret, udhëzim, leje ose dispozita të ngjashme të zbatueshme mbi asetet dhe pronat (qofshin këto të luajtshme ose të paluajtshme, të trupëzuara apo të patrupëzuara, në pronësi, të licencuara, të marra me qira ose ndryshe) ose mbi kontratat dhe të drejtat që ka Shoqëria, të cilat mund të shkaktojnë një ndryshim material përkeqësues mbi aktivitetin dhe biznesin e saj.

Shoqëria zotëron në mënyrë të rregullt dhe të vlefshme dhe nuk ka shkelur asnjë leje, licencë apo miratime ose autorizime të tjera, që parashikohen prej ligjeve, rregullave, rregulloreve, urdhrave, dekreteve ose udhëzimeve të zbatueshme për pronësinë, përdorimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e aktivitetit të saj ose për çdo aset dhe pronë të saj ose për çdo kontratë dhe të drejtë, që Shoqëria ka detyrimin të zbatojë.

Shoqëria, rrjeti i saj, pajisjet, dhe në përgjithësi mënyra se si Shoqëria ushtron aktivitetin e saj është në përputhje me legjisllacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit. Shoqëria nuk ka detyrime në lidhje me mjedisin.

Procesi i privatizimit të shoqërisë dhe përzgjedhja e Blerësit si fitues i tenderit është kryer në përputhje me ligjin për privatizimin, me ndryshimet përkatëse, dhe me çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor të zbatueshëm.

#### 5.14 GARANCITË, DETYRIMET DHE DËMSPËRBLIMET

Shoqëria nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes, me përjashtim të atyre që tregohen në shtojcën K. Eagle Mobile nuk ka asnjë detyrim të papaguar dhe nuk ka rënë dakord të krijojë ose të marrë hua, të marrë borxh ose detyrime të natyrës së huamarrjes.

Shoqëria ose Eagle Mobile nuk është palë dhe nuk është përgjegjëse në bazë të ndonjë marrëveshjeje siguroese, dëmspërblimi ose marrëveshjeje tjetër për të siguruar ose marrë përsipër ndonjë detyrim financiar ose detyrim tjetër në lidhje me detyrimet e një pale të tretë.

#### 5.15 MBYLLJA , ADMINISTRIMI DHE PAMUNDËSIA E PAGESËS

Nuk është miratuar asnjë urdhër, nuk është paraqitur asnjë peticion dhe nuk është marrë asnjë vendim për mbylljen e Shoqërisë ose Eagle Mobile, ose për emërimin e një likuidatori të përkohshëm për Shoqërinë ose Eagle Mobile, dhe nuk është miratuar asnjë urdhër për vënien në administrim të Shoqërisë ose Eagle Mobile; dhe se Shoqëria ose Eagle Mobile nuk është në pamundësi ose e paafte të paguajë borxhet e saj.

#### 5.16 PULLAT E TAKSËS, TAKSAT DHE DETYRIME TË TJERA

Nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pullat, taksat, përfshirë TVSH (tatimi mbi vlerën e shtuar), ose detyrime të tjera të pagueshme nga Blerësi në lidhje me këtë Kontratë dhe me transferimin e aksioneve në emër të Blerësit.

#### 5.17 SHTOJCAT

Shtojcat e mëposhtme që i janë bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje do të quhen si pjesë përbërëse e saj:

Shtojca A: Forma e deklaratës së çmimit të blerjes;

Shtojca B: Forma e certifikatës së aksioneve;

Shtojca C: Licencat;

Shtojca D: Lista e marrëveshjeve të nënshkruara nga Shoqëria, pas datës së fundit kontabël, vlera e të cilave kalon shumën prej 100 000 (njëqind mijë) euro;

Shtojca E: Vërtetim për likuidimin e detyrimeve të sigurimeve shoqërore;

Shtojca F: Raport në lidhje me çështjet gjyqësore në proces;

Shtojca G: Lista e pasurive të paluajtshme të Shoqërisë;

Shtojca H: Lista e stacioneve ekzistuese SW, Local Net, FO dhe MW të Shoqërisë;

Shtojca I: Lista e asetëve dhe pajisjeve të Shoqërisë (inventari);

Shtojca J: Lista e licencave për markat tregtare dhe patentat e Shoqërisë dhe Eagle Mobile;

Shtojca K: Kontrata e huasë e nënshkruar nga Shoqëria dhe Eagle Mobile;

Shtojca L: Plani i biznesit i Blerësit;

Shtojca M: Llogaritë e Shoqërisë;

Shtojca N: Pasqyrë e dokumenteve të data room-it;

Shtojca O: Garancia fillestare;

Shtojca P: Letra e angazhimit dhe drafti i letrës së patronazhit;

Shtojca Q: Raporti i organeve tatimore;

Shtojca R: Lista e prokurimeve pas datës së fundit kontabël.

Për të shmangur çdo dyshim, Shitësi garanton dhe deklaron se përmbajtja e shtojcave të mësipërme është e vërtetë dhe e saktë dhe do të jetë e tillë dhe në datën e mbylljes.

### Neni 6

#### **Deklarimet dhe garancitë e Blerësit**

Blerësi bën deklaratimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Shitësit dhe secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë në datën e mbylljes.

#### 6.1 ORGANIZMI

Blerësi është një shoqëri e themeluar dhe e organizuar rregullisht dhe që ushtron veprimtarinë e tij sipas të drejtës së Republikës së Turqisë, nuk është në gjendje paafësie paguese, dhe ka kompetenca dhe autoritet të plotë të kryejë aktivitetin e tij, siç e kryen aktualisht dhe të zotërojë asetet dhe pronat e tij, siç i zotëron aktualisht.

## 6.2 AUTORIZIMI

Të gjitha aktet e Shoqërisë dhe/ose procedurat e tjera që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Blerësit që autorizojnë Blerësin të lidhë dhe zbatojë këtë Kontratë janë ndërmarrë rregullisht, kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar nga Blerësi në mënyrën e duhur dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv ndaj tij, në përputhje me afatet dhe kushtet e saj.

Për nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk duhet asnjë njoftim tjetër ose depozitim, miratim, autorizim i çfarëdolloj nga ndonjë autoritet publik kombëtar apo nga ndonjë autoritet qeveritar ose rregullator apo nga ndonjë autoritet tjetër në shtetin e Blerësit.

## 6.3 MUNGESA E KOMISIONERËVE/BROKERA VE

Blerësi nuk ka detyrime për të paguar ndonjë komision, tarifë ndërmjetësimi ose pagesa të ngjashme në lidhje me transaksionin e parashikuar në këtë Kontratë, pagimi i të cilave mund të pretendohet në mënyrë të vlefshme nga Shoqëria ose Shitësi.

## 6.4 MUNGESA E KONFLIKTEVE

Nënshkrimi dhe dorëzimi i kësaj Kontrate, përfundimi i transaksioneve të parashikuara nga kjo Kontratë dhe përmbushja e kushteve, afateve dhe dispozitave të kësaj Kontrate nga Blerësi nuk do të bjerë në konflikt, nuk do të shkelë apo mospërmbushë, ose të krijojë ndonjë të drejtë për përfundimin, anulimin ose përshpejtimin e ndonjë detyrimi ose humbjeje në përfitim material, dhe as nuk do të krijojë barrë mbi ndonjë aktivitet, aset ose pronat e Blerësit, sipas dispozitave të (i) statutit të Blerësit ose të dokumenteve të tjera të shoqërisë; ose (ii) të ndonjë kambiali, bonoje, hipoteke, porosi, akt besimi, licencë, qira, kontratë ose marrëveshje, në të cilat Blerësi është palë; ose (iii) të ndonjë vendimi gjyqësor, urdhri, dekreti, rregulli ose rregulloreje të zbatueshme për Blerësin ose mbi biznesin, asetet ose pronat e Blerësit.

Nënshkrimi i kësaj Kontrate nuk përbën shkelje të ndonjë ligji ose apo të vetë akteve të shoqërisë të Blerësit, që mund të ndikojnë në vlefshmërinë ose ekzekutimin e kësaj Kontrate.

## 6.5 DUE DILIGENCE

Blerësi deklaron se ka kryer kontrollin e tij - *due diligence* - mbi biznesin dhe veprimtarinë e Shoqërisë, dhe se nuk është mbështetur dhe as mbështetet në asnjë deklaram apo garanci nga ana e Shitësit, përveç atyre që parashikohen në këtë Kontratë.

## Neni 7

### **Premtimet e Shitësit**

7.1 Shitësi premtan se gjatë periudhës midis nënshkrimit dhe mbylljes:

i) Shoqëria dhe Eagle Mobile do të ushtrojnë aktivitetet e tyre brenda kufijve të administrimit të zakonshëm, përveçse kur është rënë dakord ndryshe me shkrim me Blerësin;

ii) Shoqëria dhe Eagle Mobile do të ndërmarrin të gjitha hapat e nevojshme për të ruajtur asetet dhe pronat e tyre në vlerën që parashikohet në llogaritë, si edhe organizimin e biznesit, klientët dhe personelin;

iii) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të lëshojnë ose emetojnë (qoftë me të drejtë preferenciale, ose ndonjë të drejtë tjetër të konvertueshme në aksione apo tjetër mbi aksionet) asnjë aksion në kapitalin e Shoqërisë ose Eagle Mobile;

iv) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të kryejnë asnjë ndryshim në aktet e tyre të themelimit dhe rregulloret e brendshme, përveçse kur parashikohet ligjërisht për shitjen e aksioneve;

v) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të ndryshojnë afatet dhe kushtet e punësimit për asnjë nga drejtorët ose stafin profesional të vjetër të tyre ose nuk do të kryejnë pagesa përfshirë shpërblime për punonjësit e tyre, ndryshe nga sa parashikohet në kontratat ekzistuese, në kontratat kolektive, ose në praktikat e zakonshme të mëparshme ose të punësojnë punonjës të rinj ndryshe nga zhvillimi i zakonshëm i aktivitetit të Shoqërisë;

vi) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të përfitojnë ose disponojnë ose bien dakord për të përfituar ose disponuar ndonjë aset material apo pronë;

vii) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të ndërpresin apo të ndalojnë zhvillimin e gjithë apo një pjese materiale të biznesit të tyre;

viii) Shoqëria ose Eagle Mobile do të përmbushin të gjitha detyrimet ndaj autoriteteve rregullatore, tatimore dhe atyre të sigurimeve shoqërore;

ix) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të nënshkruajnë ose të rrisin, ose të zgjerojnë ndonjë përgjegjësi nën ndonjë garanci ose dëmshpërblim, ose tjetër jashtë kufijve të aktivitetit të zakonshëm të biznesit të tyre;

x) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të hyjnë në asnjë marrëveshje që nuk përfundohet mbi baza të barabarta dhe të drejta për palët e saj, ose që mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues;

xi) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të lidhin asnjë kontratë që nuk është brenda kufijve të zhvillimit të zakonshëm të bizneseve të tyre, dhe do të marrin miratimin me shkrim të Blerësit për kontrata, vlera e të cilave kalon shumë prej 100 000 (njëqind mijë) eurosh për çdo transaksion dhe/ose shumë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro së bashku;

xii) Shoqëria dhe Eagle Mobile do të përpiqen që standardet e shërbimeve që i ofrojnë klientëve të jenë së paku shërbime me standard dhe cilësi të krahasueshme me shërbimet që këto shoqëri i kanë ofruar klientëve para datës së nënshkrimit të kësaj Kontrate;

xiii) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të vonojnë pagesat, ndryshojnë faturimet ose rristrukojnë kushtet e pagesave për borxhet e tyre ndryshe nga praktikat e mëparshme të biznesit të tyre, që mund të shkaktojë një ndryshim material përkeqësues;

xiv) Shoqëria dhe Eagle Mobile nuk do të paguajnë, plotësojnë ose përmbushin asnjë pretendim, përgjegjësi, ose detyrim, përveç atyre që i përkasin aktivitetit të zakonshëm të bizneseve të tyre dhe pa u këshilluar me Blerësin kur këto shuma kalojnë vlerën prej 100 000 (njëqindmijë) eurosh, për çdo transaksion dhe/ose 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro së bashku;

xv) Shoqëria ose Eagle Mobile nuk do të përfundojnë, ndryshojnë ose nënshkruajnë ndonjë transaksion, ose as të ndryshojnë ose përfundojnë ndonjë transaksion, ose kontratë vlera e të cilës kalon shumë prej 100 000 (njëqindmijë) eurosh për çdo transaksion dhe/ose 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro së bashku, dhe që mund të shkaktonte një ndryshim material përkeqësues mbi asetet, pronat, veprimtarinë e bizneseve të Shoqërisë ose Eagle Mobile;

xvi) Shoqëria dhe Eagle Mobile nuk do të pësojnë asnjë detyrim material ose përgjegjësi materiale ose ndryshim material përkeqësues;

xvii) Shoqëria do të fillojë procedurën e regjistrimit të rrjetit të Albtelecom-it në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, menjëherë pas lëshimit të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave mbi miratimin e listës së inventarit dhe urdhrin vijues të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për regjistrimin e pasurive në fjalë;

xviii) Shoqëria do të dorëzojë llogaritë mbi administrimin e Albtelekom-it dhe Eagle Mobile që nga Janari 2007 deri në datën e mbylljes.

Brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e nënshkrimit, Blerësi mund të komunikojë Shitësit dhe Shoqërisë emrat e përfaqësuesve të Blerësit, numri i të cilëve mund të jetë deri në 5 (pesë), që do të kenë të drejtë të plotë aksesi në Shoqëri dhe në aktivitetet e saj deri në mbyllje.

7.2 Shitësi do të ushtrojë përpjekjet e tij më të mira, me qëllim që të asistojë Blerësin dhe Shoqërinë, në përputhje me kuadrin ligjor shqiptar në fuqi, që pas mbylljes:

i) të qartësohet plotësisht qëllimi i detyrimit të shërbimit universal (“DSHU”);

ii) të përcaktohen operatorët e telekomunikacioneve që do të angazhohen me DSHU, dhe nëse është e nevojshme do të aktivizohet një mekanizëm financiar për këtë qëllim, duke marrë parasysh nevojat publike dhe zhvillimet teknologjike të tregut shqiptar të telekomunikacioneve;

iii) Autoritetet qeveritare nuk do të shkaktojë dhe nuk do të zbatojnë asnjë nga rastet e mëposhtme: (i) dënim, nacionalizim, rekuzionim, urdhër komandues, konfiskim, blerje e detyrueshme, shpronësim i të gjitha ose të një pjese të aksioneve në shitje të Shoqërisë, biznesit të saj, të pronave, asetëve të Eagle Mobile ose të licencave; (ii) kujdestari apo kontroll i të gjitha ose të një pjese thelbësore të aksioneve në shitje të Shoqërisë, të biznesit të saj, të pronave, të asetëve të Eagle Mobile; ose të licencave; ose (iii) veprime për prishjen apo çregjistrimin e Shoqërisë ose Eagle Mobile ose (iv) veprime që ndalojnë Blerësin për të ushtruar aktivitetin e tij ose operacionet e

biznesit apo ushtrimin e ndonjë pjese thelbësore të aktivitetit siç kryhet aktualisht;

iv) Për çdo shpërblim të punonjësve të Shoqërisë ose Eagle Mobile në lidhje me largimin e tyre nga puna pas mbylljes, nëse ka, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

## Neni 8

### Premtimet e Blerësit

#### 8.1 MBAJTJA E SELISË LIGJORE NË SHQIPËRI

Blerësi do të mbajë selinë ligjore të Shoqërisë në Republikën e Shqipërisë.

#### 8.2 INVESTIMET DHE PLAN BIZNESI

Blerësi do të bëjë përpjekjet e tij më të mira për të zhvilluar aktivitetet e Shoqërisë me qëllim që ta bëjë këtë biznes konkurrues dhe efikas në treg, në përputhje me planin e tij të biznesit, siç përshkruhet në shtojcën L.

Në mënyrë të veçantë, Blerësi do të ushtrojë përpjekjet e tij më të mira për të zbatuar brenda periudhës së parashikuar prej 5 (pesë) vitesh, vlerën e investimeve që parashikohet në planin e biznesit, sipas tregut dhe kushteve tregtare të zbatueshme në Shqipëri. Shitësi ka të drejtë të monitorojë zbatimin e planit të biznesit dhe Blerësi do të bëjë të mundur që Shoqëria të udhëzojë çdo vit ekspertët kontabël të autorizuar të saj, që të identifikojnë në raportin vjetor të auditimit të pasqyrave financiare të Shoqërisë, investimet e kryera.

Në rast se, pas 5 (pesë) vjetësh nga mbyllja e kësaj kontrate, Blerësi nuk ka kryer të paktën 80% (tetëdhjetë për qind) të vlerës së investimeve që parashikohet në planin e biznesit, lidhur me investimet që janë parashikuar për t'u realizuar deri në vitin e pestë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën e barabartë me 20% (njëzet për qind) të vlerës së investimit të pakryer për çdo vit, deri sa të plotësohet shuma totale e investimeve të pakryera.

Në rast se, pas 5 (pesë) vjetësh nga mbyllja e kësaj Kontrate, Blerësi do të ketë kryer të paktën 80% (tetëdhjetë për qind) të vlerës së investimeve që parashikohet në planin e biznesit, lidhur me investimet që janë parashikuar për t'u realizuar deri në vitin e pestë, Blerësi do t'i paguajë Shitësit shumën e barabartë me 2% (dy për qind) të vlerës së investimit të pakryer për çdo vit, deri sa të plotësohet shuma totale e investimeve të pakryera.

Pavarësisht nga sa më lart, në rast se investimet e propozuara nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur dhe në kohë për shkak të një rasti që del jashtë kontrollit të Blerësit, e tillë si forca madhore apo çdo rast tjetër me të njëjta pasoja si kjo e fundit, si rrjedhojë Blerësi nuk është i detyruar t'i paguajë ndonjë penalitet Shitësit.

#### 8.3 TITULLI I PRONËSISË MBI AKSIONET

Blerësi do të zotërojë drejtpërsëdrejti ose indirekt shumicën e aksioneve të Shoqërisë ose të paktën 1/3 (një të tretën) e aksioneve të shoqërisë bashkë me të drejtat kontrolluese për të paktën 5 (pesë) vjet, duke filluar nga mbyllja, përveç rastit kur Shitësi bie dakord ndryshe.

Në rast se aksionari i Shoqërisë është Shoqëria e Re dhe palët e ortakërisë kanë për qëllim të transferojnë pjesët e tyre të kapitalit të Shoqërisë së Re ose të Shoqërisë mëmë sipas rastit, palëve të treta, në tërësi apo pjesërisht, Shitësi ka të drejtë të shprehë miratimin e tij në lidhje me përfituesin e propozuar të transferimit, të paktën për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh duke filluar nga data e mbylljes. Për këtë qëllim, palët e ortakërisë, duhet t'i komunikojnë me shkrim Shitësit identitetin e përfituesit të propozuar të transferimit dhe kushtet e transferimit. Shitësi do të shprehë miratimin e tij për përfituesin e propozuar të transferimit, brenda 20 (njëzet) ditëve duke filluar që nga data e marrjes së këtij komunikimi, në të kundërt miratimi i Shitësit do të konsiderohet i refuzuar. Transferimi i aksioneve, pa pëlqimin e Shitësit, do të konsiderohet nul dhe i pavlefshëm dhe palët e ortakërisë do t'i paguajnë Shitësit një penalitet në shumën prej 5 000 000 (pesë milionë) eurosh.

Në rast se aksionari i Shoqërisë është Shoqëria e Re, Shitësi bie dakord se Shoqëria mund të bashkohet me Shoqërinë e Re, me nismën e CETEL-it ose të Shoqërisë së Re, me kusht që përqindja e aksioneve që Shitësi do të zotërojë në Shoqëri pas bashkimit të mos jetë e ndryshme nga përqindja e aksioneve që Shitësi zotëron aktualisht tek Albtelecom-i.

Blerësi angazhohet të sigurojë që Shitësi do të zotërojë një paketë aksionesh në kapitalin e Shoqërisë, ose në shoqërinë që do të rezultojë nga bashkimi i sipërpërmendur i shoqërive, që nuk është e ndryshme nga paketa e aksioneve (në përqindje) që Shitësi zotëron aktualisht në kapitalin e Albtelecom, gjithashtu edhe në rast të zmadhimit të kapitalit të Shoqërisë për 1 (një) vit pas mbylljes.

#### 8.4 BASHKËPUNIMI ME TURK TELEKOMUNIKASYON A.S.

Në rast se kontrata e menaxhimit midis Blerësit dhe Turk Telekomunikasyon A.S. do të mbarojë përpara afatit të parashikuar në të, Blerësi do të hyjë në një kontratë të re menaxhimi, ose do të mundësojë që Shoqëria të hyjë në një kontratë të re menaxhimi, sipas rastit, me një operator të mirënjohur, me eksperiencë dhe reputacion të mirë në fushën e telekomunikacioneve, të telefonisë fikse dhe të lëvizshme, të pranueshme nga Shitësi, brenda 6 (gjashtë) muajve nga përfundimi i kontratës së parë të menaxhimit.

### Neni 9

#### **Premtime të përbashkëta të palëve**

Palët heqin dorë nga çdo veprim, dhe do njoftojnë njëra-tjetrën menjëherë për çdo zhvillim, i cili mund të rrezikojë apo vonojë përfundimin e transaksionit. Palët do të ndihmojnë njëra-tjetrën në mënyrë të arsyeshme me qëllim që të përmbushin kushtet paraprake të parashikuara në këtë Kontratë.

Palët bien dakord të ndryshojnë statutin e Shoqërisë përpara mbylljes dhe të bien dakord bashkërisht për tekstin e ndryshimeve të propozuara përpara kësaj date, me qëllim që të parashikojnë në statut (i) të drejtën e Shitësit, të caktojë një anëtar të Këshillit Mbikëqyrës, (ii) të drejtën e Shitësit për të miratuar përfituesin e propozuar të transferimit, (iii) të drejtën e Shitësit të mbajë të njëjtën përqindje aksionesh, siç përcaktohet në Kontratë, sipas neneve 4.3 dhe 8.3.

Blerësi dhe Shitësi, do t'i sigurojnë njëri-tjetrit çdo dhe të gjithë informacionin e nevojshëm për përfundimin e transaksionit, përveç atyre që lidhen me forcat ushtarake, forcat policore, mbrojtjen kombëtare apo shërbimin informativ.

Blerësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet brenda kompetencave të tij, që janë të nevojshme për përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 10 më poshtë. Blerësi do të depozitojë menjëherë çdo kërkesë pranë çdo autoriteti qeveritar – duke përfshirë, për të evituar çdo dyshim, autoritetin shqiptar të konkurrencës – çdo kërkesë për miratim nga ana e organeve qeveritare apo njoftim që nevojitet për përmbushjen e transaksionit, brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e nënshkrimit. Shitësi do të ushtrojë përpjekjet e tij më të mira për të asistuar Blerësin në procesin e depozitimit. Blerësi merr përsipër që t'i sigurojë çdo autoriteti qeveritar çdo dhe të gjithë informacionin e kërkuar dhe/ose dokumentacionin që lidhet me të.

Shitësi do të bashkëpunojë dhe do mundësojë që Shoqëria të bashkëpunojë me Blerësin, ose të veprojë direkt, kur është e nevojshme apo sipas kërkesave të legjisllacionit të zbatueshëm, për të përgatitur depozitimet që kërkohen, pranë autoriteteve qeveritare, siç përcaktohet në nenin 10.1 më poshtë dhe do të mundësojë që Shoqëria t'i sigurojë Blerësit dokumentet dhe informacionin, të nevojshme për qëllimet e depozitimit (ve).

Palët bien dakord që të kontrollojnë së bashku përmbushjen e të gjitha kushteve të mbylljes me qëllimin që mbyllja të ndodhë në fund të muajit shtator 2007. Për këtë qëllim, në fund të muajit korrik do të organizohet një takim midis Palëve.

### Neni 10

#### **Kushtet e mbylljes**

Detyrimi i Blerësit për të blerë aksionet në shitje dhe detyrimi i Shitësit për t'i shitur aksionet në shitje Blerësit, është i kushtëzuar nga përmbushja ose heqja dorë, në ose para datës së mbylljes të kushteve të mëposhtme:

## 10.1 AUTORIZIMET

Të gjitha autorizimet, miratimet, urdhrat ose aprovimet, deklaratimet, depozitimet ose te ketë kaluar afati i nevojshëm i kohës së pritjes i vendosur nga ndonjë autoritet qeveritar ose ent, të nevojshme për realizimin e shitjes dhe të blerjes së aksioneve në shitje, do të jenë marrë ose depozituar nga Shitësi ose do të kenë ndodhur, ose sipas rastit, autoriteti kompetent do të ketë hequr dorë prej tyre.

Në veçanti, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Shqipërisë, TRE, Këshilli i Ministrave ose autoritete të tjera kompetente, do të kenë lëshuar një vendim për miratimin e blerjes së aksioneve në shitje nga Blerësi, sipas legjislacionit të zbatueshëm në Shqipëri.

Këshilli i Ministrave do t'i ketë paraqitur ketë Kontratë Kuvendit, dhe ky i fundit do ta ketë ratifikuar atë.

## 10.2 MUNGESA E VENDIMEVE PËR NDALIMIN OSE KUFIZIMIN

Asnjë ligj i zbatueshëm ose vendim i miratuar, i shpallur, në zbatim ose që është nxjerrë nga një autoritet qeveritar, as edhe ndonjë kufizim ose pengesë tjetër ligjore, që ndalojnë kryerjen e blerjes dhe shitjes së aksioneve në shitje, nuk do te jetë në fuqi.

## 10.3 KUSHTET PËR DETYRIMIN E BLERËSIT

Detyrimi i Blerësit për të blerë aksionet në shitje dhe për të paguar për aksionet në shitje në mbyllje, është i kushtëzuar nga përmbushja (ose heqja dorë nga Blerësi), në ose para datës së mbylljes, e kushteve të mëposhtme:

### a) DEKLARIMET DHE GARANCITË

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit në këtë Kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet thelbësore, që nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe në momentin e mbylljes, sikur të jenë kryer në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci lidhen shprehimisht me një datë të mëparshme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në çdo kuptim thelbësor, në dhe që nga kjo datë e mëparshme), përveç rasteve kur, veç e veç ose bashkërisht, duket se, nuk do të shkaktojnë një ndryshim material përkeqësues.

### b) PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE TË SHITËSIT

Shitësi do të ketë kryer ose përmbushur, në çdo aspekt thelbësor, të gjitha detyrimet dhe premtimet sipas kësaj Kontrate, për t'u kryer ose përmbushur nga Shitësi në datën e mbylljes, përveç rasteve kur, veç e veç ose bashkërisht, duket se, nuk do të shkaktojnë një ndryshim material përkeqësues.

### c) MUNGESA E ÇËSHTJEVE NË PROCES

Në datën e mbylljes nuk do të ketë asnjë proces të papërfunduar nëpërmjet të cilit kërkohet: (i) kufizimi ose ndalimi i shitjes dhe blerjes së aksioneve në shitje Blerësit; (ii) ndalimi ose kufizimi i titullit të pronësisë ose funksionimit të shoqërisë nga Shitësi ose titullit të pronësisë ose funksionimit të Eagle Mobile; nga Shoqëria apo të çdo pjesë thelbësore të aktivitetit apo asetëve të Shoqërisë dhe Eagle Mobile, (iii) të kufizohet aftësia e Blerësit për të fituar ose zotëruar, ose për të ushtruar të drejta të plota të pronësisë mbi aksionet në shitje; apo (iv) të ndalohet Blerësi të kontrollojë në mënyrë efikase Shoqërinë, dhe nëpërmjet Shoqërisë dhe Eagle Mobile. Pavarësisht nga sa me sipër, do të konsiderohet se Blerësi do të ketë hequr dorë nga ky kusht, si dhe nga çdo proces, padi, apo procedim, (përveç ndonjë procesi, padie, apo procedimi nga ndonjë autoritet qeveritar) në rast se Shitësi dëmshpërblen Blerësin, në formën dhe në përmbajtjen e kënaqshme për këtë të fundit, në lidhje me këtë proces, padi, apo procedim.

## 10.4 KUSHTET PËR DETYRIMIN E SHITËSIT

Detyrimi i Shitësit për të shitur, transferuar dhe dorëzuar aksionet në shitje është i kushtëzuar nga përmbushja (ose i heqja dorë nga Shitësi), në ose para datës së mbylljes, i kushteve të mëposhtme:

### a) DEKLARIMET DHE GARANCITË

Deklarimet dhe garancitë e Shitësit në këtë Kontratë do të jenë të vërteta dhe të sakta në të



gjitha aspektet thelbësore, që nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe në momentin e mbylljes, sikur të jenë kryer në këtë kohë, përveç rastit kur këto deklarata dhe garanci lidhen shprehimisht me një datë të mëparshme (rast në të cilin këto deklarata dhe garanci do të jenë të vërteta dhe të sakta në çdo kuptim thelbësor në dhe që nga kjo datë e mëparshme), përveç rasteve kur, veç e veç ose bashkërisht, duket se nuk do të shkaktojnë një ndryshim thelbësor përkeqësues.

#### b) PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE TË SHITËSIT

Blerësi do të ketë kryer ose përmbushur, në çdo aspekt thelbësor, të gjitha detyrimet dhe angazhimet sipas kësaj Kontrate, që duhet të kryhen ose të përmbushen në kohën e mbylljes.

#### c) MUNGESA E PROCEDIMEVE

Në datën e mbylljes nuk do të ketë asnjë proces të papërfunduar apo rast në proces nga ndonjë autoritet qeveritar në territorin e Shqipërisë: (ose nga ndonjë person tjetër ndonjë çështje që ka mundësi të arsyeshme suksesi) me anë të të cilit kufizohet ose ndalohej shitja dhe blerja e aksioneve në shitje apo nëpërmjet të cilit kërkohet nga Shitësi dëmshpërblim material në lidhje me Shitësin lidhur me shitjen dhe blerjen e aksioneve në shitje; pavarësisht nga sa më sipër, Shitësi do konsiderohet se ka hequr dorë nga ky kusht, si dhe nga çdo proces, padi apo procedim, (përveç ndonjë procesi, padie apo procedimi nga ndonjë autoritet qeveritar) në rast se Blerësi nën diskrecionin e tij, dëmshpërblen Shitësin, në formën dhe në përmbajtje të kënaqshme për këtë të fundit, në lidhje me këtë proces, padi apo procedim.

### Neni 11

#### Dëmshpërblimi nga shitësi

##### 11.1 Përgjegjësia e Shitësit

Shitësi bie dakord dhe pranon, të mos dëmtojë dhe të dëmshpërblejë, Blerësin dhe/ose Shoqërinë, sipas rastit, në përputhje me kushtet dhe brenda kufizimeve, të rëna dakord më poshtë, nga çdo Humbje që rrjedh nga ose varet nga fakte ose rrethana që kanë ndodhur para datës së mbylljes, edhe nëse humbja verifikohet pas kësaj date.

Çdo dëmshpërblim që duhet të paguhet nga Shitësi, sipas kësaj Kontrate, do të bëhet i pagueshëm vetëm kur humbja përkatëse do të jetë vendosur sipas një vendimi gjyqësor, vendimi gjykate arbitrazhi apo të një autoriteti qeveritar, përfshirë por pa u kufizuar në ERT, Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritetet tatimore, dhe do të jetë bërë e pagueshme.

Për qartësi, asnjë shkelje ose supozim për shkelje të një deklarimi, garancie apo premtimi nga Shitësi nuk i jep të drejtë Blerësit të dëmshpërblehet, përveç rastit kur kjo shkelje i shkakton humbje Blerësit dhe/ose Shoqërisë, sipas detyrimeve të përcaktuara nga një vendim gjyqësor, vendim i gjykatës së arbitrazhit apo i ndonjë autoriteti qeveritar, përfshirë por pa u kufizuar në ERT, Autoritetin e Konkurrencës dhe autoritetet tatimore.

##### 11.2 KARAKTERI UNIK DHE PËRJASHTUES I MASAVE MBROJTËSE

Është rënë dakord që e drejta për të përfutur dëmshpërblim sipas kësaj dispozite, përjashton dhe i heq të drejtën Blerësit të përfitojë ndonjë kompensim, dëmshpërblim apo përfitim në dispozicion të Blerësit në lidhje me shkeljen e deklarimeve dhe garancive nga ana e Shitësit siç përcaktohet në Nenin 5.

##### 11.3 PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET

Detyrimi për dëmshpërblim i Shitësit sipas kësaj Kontrate, do të bëhet efektiv (i kërkueshëm) vetëm nëse, shuma totale e humbjeve, objekt i kërkesës për dëmshpërblim nga ana e Blerësit, në total kalon shumë prej 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) eurosh, me kusht që edhe nëse kalohet ky kufi, Shitësi do të jetë i detyruar të paguajë vetëm diferencën mbi shumën 350,000 (treqind e pesëdhjetë mijë) euro.

Në asnjë rast, shuma totale që do të paguhet nga Shitësi si dëmshpërblim, në bazë të këtij neni, nuk do të kalojë 20 % (njëzet për qind) të çmimit të blerjes.

Shuma, që duhet të paguhet nga Shitësi sipas kësaj dispozite, do të i paguhet Blerësit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas njoftimit që Blerësi i kryen Shitësit për humbjen që është bërë e kërkueshme për tu paguar.

Në rast se Shitësi vonon në kryerjen e kësaj pagese, mbi shumën që duhet të paguhet do të

aplikohet interes i barabarte me koston ndërkombëtare të interesit të financimit, që llogaritet me një mesatare mujore prej 3 (tre) - muaj EURIBOR, i përcaktuar nga Banka Qendrore Europiane. Interesi do të aplikohet deri në ditën që Shitësi do të kryejë këtë pagesë. Në rast se edhe pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve vonesë shuma nuk do të jetë paguar, Blerësi duke ruajtur çdo dhe të gjitha të drejtat e tij ligjore, ka të drejtë të kompensojë drejtpërsëdrejti pagesën e kësaj shume me ndonjë shume që Blerësi dhe/ose Shoqëria duhet t'i paguajë Shitësit. Kompensimi nuk mund të zbatohet në lidhje me pagesën e çmimit të plotë të blerjes. Në rastin e blerjes së kompensimit, Shitësi duke vepruar në mirëbesim do të paraqesë çdo dhe të gjitha dokumentet dhe informacionin e nevojshëm për të siguruar që veprimet e kompensimit janë kryer në mënyrën dhe kohën e duhur.

Shumës që duhet të paguhet nga Shitësi sipas këtij neni, në lidhje me ndonjë kërkesë për dëmshpërblim, do t'i zbritet: (i) çdo shumë që Shoqëria mund të ketë përfituar nga ndonjë policë sigurimi në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate ose nga çdo palë e tretë lidhur me çështjen përkatëse që është objekt i kërkesës për dëmshpërblim për Shoqërinë; (ii) çdo përfitim nga taksat që ka përfituar Blerësi ose Shoqëria si rrjedhojë e një rasti që përbën shkak për dëmshpërblim.

Në çdo rast, Shitësi nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi ndaj Blerësit në lidhje me ndonjë shkelje të pretenduar të deklarimeve dhe garancive, nëse Shitësi nuk është njoftuar për shkeljen brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga data e nënshkrimit të kësaj Kontrate.

#### 11.4 E DREJTA E SHITËSIT NË LIDHJE ME HUMBJET

Blerësi, bie dakord të njoftojë Shitësin për çdo fakt që mund t'i shkaktojë Shoqërisë një humbje, për dëmshpërblimin e së cilës Shitësi mund të jetë përgjegjës menjëherë pas marrjes dijeni mbi faktet, dhe në çdo rast brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes dijeni, me kusht që nëse afati i fundit për depozitimin e një ankese ose kundërshtimi në lidhje me këtë humbje është më pak se 30 (tridhjetë) ditë, Shitësi duhet të njoftohet në kohë nga Blerësi, sipas afateve ligjore, me njoftim me shkrim ku të përcaktohet pretendimi në detaje bashkë me gjithë dokumentacionin që ka në dispozicion, i cili mund të jetë i nevojshëm për të bërë të mundur që Shitësi të kryejë veprimet e duhura në lidhje me humbjen, objekt i këtij pretendimi. Për qëllimet e këtij paragrafi, detyrimet e Blerësit për t'i njoftuar Shitësit ndonjë fakt, i cili mund të çojë në një humbje për të cilën Shitësi mund të konsiderohet përgjegjës, dhe posaçërisht procedura e njoftimit 30 (tridhjetë ditor), do të nisnin pas një afati prej 45 ditësh (dyzetepesë) nga data e mbylljes.

Shitësi ka të drejtë të drejtojë menaxhimin e rrethanave, sipas rastit, të cilat janë shkak për ngritjen e pretendimeve nga ana e Blerësit dhe Blerësi bie dakord të sigurojë, sipas kërkesës së Shitësit, se Shoqëria do të: (i) informojë rregullisht dhe në kohë Shitësin për çdo njoftim, komunikim ose informacion tjetër që ka marrë në çdo lloj mënyre nga Shoqëria, në lidhje me këtë pretendim; (ii) bashkëpunojë me Shitësin në lidhje me kompensimet dhe veprimet përkatëse, duke mundësuar që Shitësi të përdorë të gjitha shënimet, dosjet dhe të dhënat që lidhen me to, dhe mbështetjen e nevojshme nga punonjësit e saj; dhe (iii) bashkëpunojë me Shitësin për kryerjen e procedurave ligjore dhe/ose zgjidhjen me mirëkuptim dhe/ose nismat e tjera në lidhje me to.

Në qoftë se Shitësi nuk bashkëpunon brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së njoftimit përkatës nga Blerësi, me përjashtim të rasteve kur kërkohet bashkëpunimi i menjëhershëm nga Shitësi me qëllim që të respektohen afatet ligjore, Blerësi pavarësisht nga sa më sipër, do të ndërmarrë të gjitha hapat e arsyeshme, përfshirë këtu zgjedhjen e avokatëve dhe këshilltarëve të tij, të nevojshëm për të zvogëluar shumën që kërkohet si dëmshpërblim dhe do mundësojë që Shoqëria të ndërmarrë të gjitha veprimet e masat e nevojshme, dhe të njoftojë menjëherë dhe në mënyrë të plotë Shitësin, për çdonjë nga këto nisma apo veprime.

Nismat që ndërmerr Blerësi apo Shoqëria lidhur me këto pretendime, pa njoftuar rregullisht Shitësin ose mospërmbushja nga Shoqëria e parashikimeve të mësipërme të po këtij neni 11.4 nuk e shkarkon Shitësin nga detyrimi i tij për të dëmshpërblyer në mënyrë të plotë Blerësin në lidhje me pretendimin përkatës.

Shitësi është i detyruar të paguajë Blerësin ose Shoqërinë sipas këtij neni, vetëm nëse dhe kur humbja përkatëse do të bëhet e pagueshme, përfshirë këtu dhe shpenzimet gjyqësore dhe tarifatat përkatëse të avokateve apo këshilltareve.

Neni 12  
**Forca madhore**

Mospërbushja e detyrimeve sipas kësaj Kontrate prej njëres nga Palët, nuk do të quhet shkelje ose mospërbushje e kësaj Kontrate, në rast se kjo mospërbushje vjen si pasojë e një force madhore, me kusht që Pala e prekur nga kjo ngjarje (a) të ketë marrë të gjitha masat paraprake të arsyeshme, përkujdesjen e duhur dhe masa të ndryshme të arsyeshme, për të përmbushur afatet dhe kushtet e kësaj Kontrate, dhe (b) të ketë njoftuar Palën tjetër sa më shpejt e mundur për këtë ngjarje.

Çdo periudhë brenda së cilës, njëra nga Palët sipas kësaj Kontrate, duhet të kryejë një veprim ose detyrë, do të zgjatet për një periudhë kohe të barabartë me periudhën gjatë së cilës kjo Palë, nuk mund të kryejë këtë veprim për shkak të forcës madhore.

Neni 13  
**Zgjidhja e Kontratës**

Kjo Kontratë mund të zgjidhet, vetëm, në rastet e mëposhtme:

a) me marrëveshje të përbashkët me shkrim ndërmjet Shitësit dhe Blerësit, në datën në të cilën do të përcaktohet aty;

b) nga Blerësi, para mbylljes, në rast se:

(i) Shitësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 10.3, me kusht që të jenë përmbushur kushtet e nenit 10.1 dhe 10.2 dhe Blerësi të ketë përmbushur detyrimet e tij, sipas nenit 10.4;

c) nga Shitësi para Mbylljes në rast se:

i) Blerësi kryen shkelje të rëndë të deklarimeve dhe garancive që parashikohen në nenin 6;

ii) Blerësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 10.4, me kusht që të jenë përmbushur kushtet që përcaktohen në nenin 10.1 dhe 10.2 dhe Shitësi të ketë përmbushur detyrimet e tij sipas nenit 10.3.

Në rast se kjo Kontratë zgjidhet sipas pikave (a), (b) dhe (c) më sipër, asnjë Palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Palës tjetër, përveç rastit kur kanë ndodhur shkelje të mëparshme në ose para datës së zgjidhjes së kësaj Kontrate. Gjithashtu, nëse kjo Kontratë zgjidhet nga Shitësi sipas paragrafit (c), garancia fillestare do të përfitohet nga Ministria sipas kushteve që janë përcaktuar prej saj sipas procedurave përkatëse.

Zgjidhja e kësaj Kontrate për çfarëdo arsye nuk shkarkon Palën nga ndonjë përgjegjësi, që në momentin e zgjidhjes ka qenë e krijuar ose që mund të krijohet nga një veprim apo mosveprim para zgjidhjes së saj.

Neni 14  
**Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni**

Kjo Kontratë rregullohet nga ligji shqiptar.

Çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë, fuqinë, interpretimin, zbatimin e detyrueshëm dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate do të zgjidhet përfundimisht nga një trup prej tre arbitrash, në përputhje me Rregullat e Pajtimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Arbitrazhi do të zhvillohet në Paris dhe gjuha e procedurave të arbitrazhit, do të jetë gjuha angleze.

Palët me anën e kësaj Kontrate, heqin dorë nga e drejta për të zbatuar ndonjë ligj tjetër, dhe deklarojnë se i njohin Rregullat e Pajtimit dhe Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë të Parisit.

Neni 15  
**Të ndryshme**

15.1 NDRYSHIMET

Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm në qoftë se bëhet më shkrim dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Palë.

Mosushtrimi ose vonesa në ushtrimin e një të drejte ose masë mbrojtjeje, që parashikohen në këtë Kontratë ose nga ligji, nuk përbën heqje dorë nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqje dorë nga të drejta ose masa të tjera mbrojtjeje. Mosushtrimi i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte ose mase mbrojtjeje që parashikohen në këtë Kontratë ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e mëtejshëm të së drejtës ose masës mbrojtëse ose ushtrimin e një të drejte ose mase tjetër mbrojtëse.

## 15.2 VLEFISHMËRIA E PAVARUR NGA NJËRA-TJETRA E DISPOZITAVE KONTRAKTORE

Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket nga një fakt i tillë.

Palët do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën më të madhe të mundshme, për të arritur qëllimin e kësaj dispozite.

## 15.3 KOPJET

Kjo Kontratë mund të nënshkruhet në një ose më shumë kopje, ku secila prej tyre e nënshkruar dhe e dorëzuar në këtë mënyrë do të quhet origjinale, por të gjitha këto kopje së bashku do përbëjnë një dhe të vetmen Kontratë; faqet e firmosura mund të shkëputen nga kopjet e shumëfishta dhe të veçanta dhe mund t'i ngjiten një kopjeje të vetme në mënyrë që të gjitha faqet e firmosura t'i ngjiten fizikisht të njëjtit dokument.

Kontrata është në versionin anglisht dhe shqip. Në rast konflikti midis dy versioneve, përparësi do të ketë versioni anglisht.

## 15.4 NJOFTIMET

Njoftimet ose komunikime të tjera sipas ose në lidhje me këtë Kontratë (“Njoftimi”) do të jenë:

- me shkrim;
- në gjuhën angleze;
- do t'i dorëzohen ose dërgohen me postë rekomande me kthim përgjigje ose teleks ose faks, Palës që duhet të marrë njoftimin në adresën e caktuar këtu më poshtë ose në një adresë tjetër të specifikuar nga kjo Palë.

Me përjashtim të rastit kur provohet se njoftimi është marrë më shpejt, njoftimi do quhet i dhënë nëse:

- është dërguar me postë, 10 (dhjetë) ditë pune, pas postimit të tij;
- është dërguar me telex, kur merret përgjigjja përkatëse konfirmuese për marrje të tij;
- dhe
- është dërguar me faks, kur konfirmimi i transmetimit të tij është regjistruar nga faksi i dërguesit.

Adresat janë:

### BLERËSI

- Emri i Palës: CETEL Çalik Enerji Telekomunikasyon Hizmetleri A.S.
- Adresa: Ak Plaza Yasam Caddesi no.7 Kat 9, 06510 Sogutozu Ankara
- Nr. Faksi.: 0090 - 312 - 207- 71 71
- Dërguar në vëmendje të: Z. Semih Ergur

### SHITËSI

- Emri i Palës: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
- Adresa: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Tiranë
- Nr. Faksi.: +355 4 227 617
- Dërguar në vëmendje të: Z. Genc Ruli

#### 15.5 KALIMI I TE DREJTAVE

Kjo Kontratë është detyrim ligjor dhe në përfitim të Palëve, trashëgimtarëve të tyre dhe personave të cilëve u kalojnë këto të drejta.

Blerësi nuk mund të kalojë dhe transferojë të drejtat e tij sipas kësaj Kontrate, në tërësi ose në veçanti, pa miratimin paraprak me shkrim të Shitësit, miratim i cili nuk do të refuzohet pa arsye.

#### 15.6 KOSTOT DHE TAKSAT

Përveç, kur parashikohet ndryshe në këtë Kontratë, secila Palë do të paguajë shpenzimet e saj në lidhje me negocimin dhe hartimin e kësaj Kontrate dhe të shtojcave të saj. Çdo dhe të gjitha shpenzimet noteriale për nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate do të paguhet nga Blerësi.

#### 15.7 HEQJA DORË NGA IMUNITETI PËR SHKAK TE SOVRANITETIT

Shitësi deklaron dhe garanton se cilësia e tij në dokumentet e transaksionit dhe përmbushja e detyrimeve që parashikohen në to, përbëjnë veprime tregtare dhe jo akte publike ose qeveritare dhe se nuk ka të drejtë të pretendojë për imunitet në procedimet gjyqësore që lidhen me të ose asetet e tij, duke u bazuar në sovranitetin ose në një ligj apo në një juridiksion ku mund të ngrihet një padi për ekzekutimin e një detyrimi që lind dhe lidhet me dokumentet e transaksionit.

Edhe nëse Shitësi ose një aset i tij kanë ose mund të fitojnë një të drejtë imuniteti në lidhje me kompensimet, procedimet ligjore, masa për sigurimin e padisë, masa të tjera apo ekzekutim të vendimit në bazë të sovranitetit ose të ndryshme nga kjo, Shitësi shprehimisht heq dorë në mënyrë të pakthyeshme nga këto të drejta për imunitet në kuptim të detyrimeve që lindin ose lidhen me dokumentet e transaksionit.

#### 15.8 MOSHEQJA DORË

Mosushtrimi dhe vonesa në ushtrimin e çdo të drejte, kompetence ose mase mbrojtëse në lidhje me këtë Kontratë (secila "E drejtë") nga Palët, nuk do të quhet si heqje dorë nga kjo e drejtë dhe asnjë ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, nuk do të përjashtojë mundësinë e ushtrimit të kësaj të drejte më vonë ose ushtrimin e ndonjë të drejte tjetër.

Të drejtat që parashikohen në këtë Kontratë janë të drejta të mëtejshme dhe nuk përjashtojnë mundësinë e përdorimit të të drejtave të tjera (kur parashikohet me ligj ose ndryshe). Çdo heqje dorë shprehimisht nga e drejta për të përdorur një masë mbrojtëse ndaj një shkeljeje të kësaj Kontrate, nuk do të quhet si heqje dorë nga ndonjë e drejtë për të përdorur masa mbrojtëse ndaj ndonjë shkeljeje që ndodh më pas.

#### 15.9 TËRËSIA E KONTRATËS

Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme midis Palëve që lidhet me objektin e kësaj Kontrate.

Unë, noteri, pasi ua lexova Palëve me zë të lartë këtë Kontratë, me ndihmën e përkthyesit, të hartuar në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën shqipe dhe në 6 (gjashtë) kopje në gjuhën angleze, u binda se Palët e gjejnë atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe e nënshkruajnë rregullisht dhe Unë vërtetoj nënshkrimin e tyre sipas ligjit shqiptar.

Tiranë, 19.6.2007

Për Shitësin,

Shteti Shqiptar

i përfaqësuar nga

Shkëlqesia e Tij, Ministri i Ekonomisë,

Tregtisë dhe Energjisë

Z. Genc Ruli  
Për dhe në emër të Blerësit

---

Z. Ahmet Calik

---

Z. Ertugrul Gurler  
Përkthyes noter

---

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468  
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1.	KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2.	KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3.	REGJISTRAT E NOTERISË	
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i.	PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii.	PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi.	PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

## TREGUES LEGJISLACIONI

1	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 3.8.2007  
Doli nga shtypi më 6.8.2007

Tirazhi: 3500 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2007

Çmimi 40 lekë